

# **NGRITJA E ISLAMIT**

**HARUN JAHJA**

**QERSHOR 2003**

# **PËRMBAJTJA**

## **Parathënie**

Islami është në ngritje

## **Kapitulli 1**

Rënia e ateizmit dhe ngritja e besimit

## **Kapitulli 2**

Përhapja e shpejtë e Islamit në Amerikë

## **Kapitulli 3**

Evropa dhe Islami

## **Kapitulli 4**

Islami po rritet në Rusi dhe Kinë, gjithashtu

## **Kapitulli 5**

Rivendosja e marrëdhënieve (Afrimi) në mes të Muslimanëve,  
të Krishterëve dhe Çifutëve

## **Përfundim**

Lajmet e gëzuara të shekullit

## **Shtojcë**

Mashtrimi i Evolucionit

# PARATHËNIE

## ISLAMI ËSHTË NË NGRITJE

Gjatë 20 viteve të fundit, numri i Muslimanëve në botë është rritur vazhdimisht. Statistikat e vitit 1973 tregojnë se popullata Muslimane në botë numëronte 500 milionë; tani, ajo ka arritur në 1.5 miliardë. Sot, çdo i katërti person është Musliman. I Ka mundësi që popullata Muslimane do të vazhdojë të rritet dhe Islami do të bëhet feja më e madhe në botë.

Arsyeja e kësaj rritjeje të vazhdueshme nuk është vetëm rritja e popullatës në vendet Muslimane, por gjithashtu numri në rritje i njerëzve të cilët po kthehen në Islam, një dukuri që ka fituar shtytje, posaçërisht pas sulmit në Qendrën Botërore të Tregëtisë më 11 Shtator 2001 (që këtej e tutje do t'i referohemi si 9/11). Ky sulm, i dënuar prej çdokujt, posaçërisht prej Muslimanëve, papritur ka tërhequr vëmendjen e njerëzve (posaçërisht të Amerikanëve) për Islamin. Njerëzit në Perëndim po flasin shumë për atë se çfarë feje është Islami, ç'thot Kur'ani, cilat obligime pasojnë me qenien Musliman dhe si duhet Muslimanët t'i udhëheqin punët e tyre. Ky interesim ka shkaktuar në mënyrë të natyrshme një ngritje në numrin e njerëzve që u kthyen në Islam në mbarë botën. Kështu, parashikimi i dëgjuar zakonisht pas 9/11 se "ky sulm do të ndryshojë rrjedhën e historisë botërore" ka filluar të jetësohet, në një mënyrë. Procesi i kthimit nga vlerat fetare dhe shpirtërore, të cilin bota është duke e përjetuar për një kohë të gjatë, është bërë kthim në Islam.

Nganjëherë, kur zhvillime të tilla raportohen prej mjeteve të informimit, shohim se sa të jashtëzakonshme në të vërtetë janë këto ngjarje. Edhe pse ndonjëherë paraqiten si ndodhi të rëndomta, ato në të vërtetë janë shenja se parimet morale Islame kanë filluar të përhapen në mbarë botën me shpejtësi të madhe.

Duhet të kuptojmë se këto shenja ose shpërfillen në dobi të ngjarjeve tjera ose nuk mund të vlerësohen drejtë prej shumë njerëzve. Mirëpo, është e një rëndësie të madhe që:

- Burra të shquar shteti citojnë Kur'anin në fjalimet e tyre dhe shfrytëzojnë çdo rast për të shprehur nderimin e tyre për të.

- Ata kanë filluar t'i vizitojnë xhamitë dhe të kërkojnë informacion të hollësishëm për Islamin.

- Për herë të parë në histori, Papa ka ftuar të Krishterët dhe Muslimanët të agjërojnë një ditë së bashku.

- Kleri i Krishterë citon Kur'anin në predikimet e tyre.

- Me javë të tëra, Kur'ani ka qenë libri më i shitur në vendet perëndimore.

- Ka pasur programe të posaçme lajmesh të transmetuara botërisht në televizion, raporte dhe programe debatuese që prezentojnë Islamin.

- Gazetat e famshme botërore kanë botuar artikuj për Islamin dhe Muslimanët.

- Librat më të kërkuar nëpër librari janë librat për Islamin dhe historinë Islame.

Ky libër paraqet dhe vlerëson këto zhvillime në mënyrë që lexuesit të mund ta vlerësojnë rëndësinë e tyre. Në njërin anë, ky libër do të bëjë përpjekje për t'i bërë besimtarët më të papërkulur dhe më të vendosur dhe, në anën tjetër, të tregoj rëndësinë që çdokujt t'i tregohet për parimet morale të Islamit. Të gjitha këto zhvillime janë shpallur në Kur'an:

**“Kur erdhi ndihma dhe çlirimi (ngadhënjimi) i Zotit dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë e Allahut. Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërko falje nga Ai (Kur’an, 110: 2-3) dhe është e rëndësishme të dijmë se ajo që thuhet në këtë varg do të bëhet realitet shumë shpejtë. Kjo po ndodhë madje edhe tani. Zoti do ta përmbush këtë premtim me të vërtetë. Prandaj, besimtarët duhet të bëjnë gjithë çka mundën për të qenë pjesë e këtyre zhvillimeve.**

# Kapitulli 1

## Rënia e Ateizmit dhe Ngritja e Besimit

Përpara se t'i hedhim një vështrim rritjes së Islamit në mbarë botën, duhet ta shqyrtojmë edhe një tjetër zhvillim vendimtar: rënien e ateizmit dhe ngritjen e besimit. Gadi çdokush që ka studiuar historinë njerëzore, veçanërisht aspektet e saj filozofike dhe shoqërore, do të pajtohet se shekulli i nëntëmbëdhjetë ishte një periudhë e rëndësishme, sepse gjatë atyre viteve u ndërmorën hapat e parë drejt rënies së ardhshme shpirtërore. Karakteristika më e rëndësishme ishte rritja e ateizmit (p.sh. të mohuarit e Ekzistencës së Zotit) si kundërvënie ndaj besimeve teiste dhe fesë, e cila ishte përgjithësisht dominante në botë deri atëherë.

Edhe pse ateizmi ka ekzistuar që prej kohërave të lashta, lindja e kësaj ideje filloi në të vërtetë në Evropën e shekullit tetëmbëdhjetë, me përhapjen dhe ndikimin politik të filozofisë së disa mendimtarëve anti-fetar. Materialistët si Denis Didero (1713-84) dhe Baron d'Holbah (1723-89) sugjeruan se gjithësia ishte një konglomerat i materies që kishte ekzistuar përgjithmonë dhe se vetëm materia ekzistonte. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ateizmi u përhap edhe më shumë. Mendimtarë si Ludvig Foerbah (1804-72), Karl Marks (1818-83), Fridrih Engels (1820-95), Fridrih Niçe (1884-1900), Emil Durkheim (1859-1917) dhe Zigmund Frojd (1856-1939) zbatuan mendimin ateist në fusha të ndryshme të shkencës dhe filozofisë.

Mbështetja më e madhe për ateizmin erdh nga Çarls Darvini (1809-82), i cili refuzoi idenë e krijimit dhe paraqiti teorinë e evolucionit, e cila kinse i dha një përgjigje shkencore çështjes që kishte hutuar ateistët me shekuj të tërë: Si erdhën në jetë qeniet njerëzore dhe gjallesat?

Kjo teori bindi një numër shumë të madh njerëzish se ekzistonte një mekanizëm në natyrë që i dha jetë materies së pajetë dhe prodhoi me miliona specie të gjalla të ndryshme prej saj.

Kah fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, ateistët formuluan një botëkuptim që "shpjegonte" gjithçka: Gjithësia nuk ishte krijuar, sepse ajo nuk kishte një fillim dhe kishte ekzistuar përgjithmonë. Ata pohonin se ajo nuk kishte një qëllim të caktuar, se rregulli dhe barazpesha e saj ishin rezultat i rastësisë dhe se teoria e evolucionit e Darvinit shpjegonte se si u krijuan qeniet njerëzore dhe gjallesat tjera. Ata besonin se Marksi dhe Durkheimi kishin shpjeguar historinë dhe sociologjinë dhe se Frojdi kishte shpjeguar psikologjinë në bazë të supozimeve ateiste. Mirëpo, zhvillimet shkencore, politike dhe shoqërore të shekullit njëzet hodhën poshtë këto pikëpamje, sepse zbulimet e vazhdueshme në astronomi, biologji, psikologji dhe shkenca shoqërore anuluan bazat e supozimeve ateiste.

Në librin e tij *Zoti: Dëshmia, Pajtimi i Besimit dhe Arsyet në një Botë Postlajke*, dijetari Amerikan Patrik Glin i Universitetit Xhorxh Uashington shkruan:

Dy dekadat e fundit të hulumtimeve kanë përmbysur gadi të gjitha supozimet dhe parashikimet e rëndësishme të një gjenerate më të hershme të mendimtarëve modern laik dhe ateist që kanë të bëjnë me çështjen e Zotit. Mendimtarët modern supozonin se shkenca do të zbulonte që gjithësia të jetë gjithnjë e më e rastësishme dhe mekanike; në vend të kësaj ajo ka zbuluar shtresa të reja të papritura të një rregulli të ndërlikuar që flet për një projektim mjeshtëror paimagjinueshëm madhështor. Psikologët modern parashikuan se feja do të tregojë si një neurozë dhe si e tejkaluar; në vend të kësaj, përkushtimi fetar është treguar të jetë një komponentë jetike e shëndetit themelor mental në aspektin empirik...

Pak njerëz duket se e kuptojnë këtë, por deri më tani kjo duhej të ishte e qartë: Gjatë një shekulli në debatin madhështor në mes të shkencës dhe besimit, raportet kanë ndryshuar plotësisht. Pas Darvinit, ateistët dhe agnostikët si (Tomas Henri) Haksli (1825-95) dhe (Bertrand) Rasel (1872-1970) mund të bënin me gisht drejt asaj që dukej të jetë një trup solid i teorisë që mund të provohej që kinse dëshmonte se jeta ishte e rastësishme dhe se gjithësia në thelb ishte e rastit. Shumë shkencëtar dhe intelektual vazhdojnë t'i qëndrojnë besnik këtij botëkuptimi. Por ata janë të shtyrë ta mbrojnë atë gjithnjë e më shumë deri në nivele gadi absurde. Sot të dhënat konkrete tregojnë fuqishëm në drejtim të hipotezës së Zotit. 2

Shkenca, e cila është paraqitur si shtyllë e filozofisë ateiste/materialiste, del të jetë pikërisht e kundërta e saj. Siç shprehet një autor tjetër: “Materializmi i prerë që përjashton çdo qëllim, zgjidhje dhe natyrë shpirtërore nga bota thjeshtë nuk mund t'i shpjegojë të dhënat që dalin nga laboratorët dhe observatoriumet.” 3

Me pak fjalë, ateizmi pësoi një rënie të papritur në çerekun e fundit të shekullit njëzet pikërisht nga vet konceptet shkencore dhe sociologjike prej të cilave pasuesit e tij kishin shpresuar të kenë përkrahjen më të madhe. Në këtë kapitull, do të shohim rënien e tij në fushat e kozmologjisë, biologjisë, psikologjisë, mjekësisë dhe sociologjisë; në pjesët e mëvonshme do të diskutohet se si kjo ka përgaditur themelin për ngritjen e Islamit.

## **Kozmologjia: Rënia e konceptit të një Gjithësie të Amshueshme dhe Zbulimi i Krijimit**

Goditja e parë që iu dha ateizmit nga shkenca e shekullit njëzet ishte në fushën e kozmologjisë. Ideja se gjithësia kishte ekzistuar përgjithmonë u hodh poshtë, sepse shkencëtarët zbuluan se ajo kishte një fillim. Me fjalë të tjera, ata dëshmuan në mënyrë shkencore se gjithësia ishte krijuar nga asgjëja.

Kjo ide e një gjithësie të përjetshme erdh në botën Perëndimore, bashk me filozofinë materialiste, nga qytetërimi klasik Grek. Ajo pohonte se vetëm materia ekziston dhe se gjithësia buron nga amshueshmëria dhe është e amshueshme. Në Mesjetë, kur kisha Katolike dominonte mendimin Perëndimor, materializmi u harrua. Mirëpo, në kohën moderne shkencëtarët Perëndimor u bënë shumë kureshtar për këto burime klasike Greke dhe ringjallën interesimin për materializëm.

Personi i parë që paraqiti një kuptim materialist të gjithësisë ishte filozofi i mirënjohur Gjerman Imanuel Kanti (1724-1804), edhe pse nuk ishte materialist në kuptimin filozofik të fjalës. Kanti sugjeroi se gjithësia ishte e amshueshme dhe se çdo mundësi mund të jetësohej vetëm përbrenda kësaj amshueshmërie. Me ardhjen e shekullit të nëntëmbëdhjetë, gjerësisht u pranua se gjithësia nuk kishte një fillim dhe se nuk kishte ekzistuar asnjë moment i krijimit. E përvetësuar me pasion nga materialist dialektik si Marksi dhe Engelsi, kjo ide gjeti rrugën e saj për në shekullin e njëzet.

Kjo ide ka qenë gjithmonë në pajtim me ateizmin, sepse të pranohej se gjithësia kishte një fillim do të nënkuptonte se Zoti e kishte krijuar atë. Prandaj e vetmja mënyrë për t'iu kundërvënë kësaj ideje ishte të pohohej se gjithësia ishte e amshueshme, edhe pse shkenca nuk e mbështeste një pohim të tillë. Xhorxh Policeri (1903-42), ithtar i paepur i këtij pohimi, u bë gjerësisht i njohur si përkrahës i materializmit dhe Marksizmit në gjysmën e parë të shekullit njëzet përmes librit të tij

*Principes Fondamentaux de Philosophie* (Parimet Fundamentale të Filozofisë). Duke pandehur se modeli i “gjithësisë së amshueshme” ishte i vlefshëm, ai kundërshtoi idenë e krijimit:

Gjithësia nuk ishte një objekt i krijuar. Po të ishte atëherë do të duhej të krijohej në çast nga Zoti dhe të vinte në jetë nga asgjëja. Për të pranuar krijimin, njeriu duhet të pranojë, në rradhë të parë, ekzistencën e një momenti kur gjithësia nuk ekzistonte dhe se diçka u krijua nga asgjëja. Kjo është diçka që shkenca nuk mund ta pranojë. 4

Duke e përkrahur idenë e një gjithësie të përjetshme, Policeri mendonte se shkenca ishte në anën e tij. Mirëpo, shumë shpejtë pas kësaj, fakti për të cilin kishte aluduar duke thënë “nëse është ashtu, ne duhet ta pranojmë ekzistencën e një krijuesi,” domethënë, se gjithësia kishte një fillim, u vërtetua. Ky fakt erdh si rezultat i teorisë së “Big Bengut” (Shpërthimit të Madh), mbase konceptit më të rëndësishëm të astronomisë së shekullit njëzet.

Teoria e Big Bengut u formulua pas një sërë zbulimesh. Në vitin 1929, astronomi amerikan Edvin Habëll (1889-1953) vërejti se galaktikat vazhdimisht largoheshin nga njëra tjetra dhe se gjithësia zgjerohej. Po të kthehej mbrapsht rrjedha e kohës në një gjithësi që zgjerohet, e tërë gjithësia duhet të ketë buruar nga një pikë e vetme. Ndërsa bënin vlerësimin e vlefshmërisë së zbulimit të Habëllit, astronomët u ballafaquan me faktin se kjo pikë e vetme ishte një realitet “metafizik” në të cilin ekzistonte një tërheqje e pafund gravitacionale pa masë. Materia dhe koha u krijuan përmes shpërthimit të kësaj pike të pa-masë. Me fjalë të tjera, gjithësia u krijua nga asgjëja.

Në njërën anë, disa astronomë konservator materialist janë përpjekur që t’i bëjnë ballë teorisë së Big Bengut dhe të mbajnë në jetë idenë e një gjithësie të amshueshme. Artur Edingtoni (1882-1944), një fizikan i mirënjohur materialist, e përmbledhi pikëpamjen e tyre fare mirë kur tha: “Filozofikisht, nocioni i një fillimi të papritur të rregullit të tanishëm të Natyrës është i neveritshëm për mua.” 5 Mirëpo, përkundër kësaj neverie, teoria e Big Bengut vazhdon të vërtetohet nga zbulimet konkrete shkencore. Në vërtetimet e tyre të bëra në vitet e 1960-ta, Arno Penzias dhe Robert Uilson zbuluan mbeturina radioaktive të këtij shpërthimi (rrezatimi i sfondit kozmik). Këto vërtetime u vërtetuan në vitet e 1990-ta nga sateliti COBE (Hulumtuesi i Sfondit Kozmik – Cosmic Background Explorer).

Të përballur me të gjitha këto fakte, materialistët u mbështetën për muri. Entoni Flu, një profesor ateist i filozofisë në Univerzitetin e Reading dhe autor i librit *Humanizmi Ateist*, e bën këtë praninë interesante:

Është e ditur se rrëfimi është i mirë për shpirtin. Prandaj unë do të filloj duke pranuar se ateisti Stratonist duhet të turpërohet nga konsensusi bashkëkohor kozmologjik. Sepse duket se kozmologët po japin një provë shkencore për atë që St. Tomas thoshte se nuk mund të vërtetohej filozofikisht; domethënë, se gjithësia kishte një fillim. Për atë kohë sa do të mendohet qetësisht që gjithësia të jetë jo vetëm e pa fund por gjithashtu edhe e pa fillim, është e lehtë të këshillohet që ekzistenca e saj e vrazhdë dhe çfarëdo që të zbulohen të jenë veçoritë e saj më fundamentale, do të duhej të pranoheshin si baza shpjeguese. Edhe pse unë mendoj se kjo ende mbetet e saktë, padyshim se nuk është as gjë e lehtë dhe as e rehatshme të mbrohet kjo pikëpamje përballë rrëfimit të Big Bengut. 6

Një shembull i reagimit ateist ndaj teorisë së Big Bengut është parë në një artikull të vitit 1989 të shkruar nga Xhon Medoksi, botues i revistës *Nature*, njëerës prej revistave më të njohura materialiste-shkencore. Në artikullin e tij, të titulluar “Poshtë Big Bengu,” Medoksi shkruajti se Big Bengu është “filozofikisht i papranueshëm,” sepse “kreacionistët (ithtarët e krijimit) dhe ata me

bindje të ngjashme ... kanë arsyetim të bollshëm në doktrinën e Big Bengut.” Ai poashtu parashikoi se “ajo vështirë se do ta mbijetonte dekadën e ardhshme.” 7

Mirëpo, përkundër shpresave të Medoksit, teoria e Big Bengut vazhdon të bëhet edhe më e besueshme dhe zbulimet e reja vazhdojnë të vërtetojnë se gjithësia u krijua.

Disa materialist kanë një pikëpamje relativisht të logjikshme në lidhje me këtë çështje. Për shembull, fizikani materialist Anglez H. P. Liptoni “padëshirë” pranon faktin shkencor të krijimit. Ai shkruan:

Mendoj ... se ne duhet ... të pranojmë se i vetmi shpjegim i pranueshëm është krijimi. E di se kjo është mallkim për fizikanët, siç është me të vërtetë edhe për mua, por nuk duhet ta refuzojmë një teori e cila nuk na pëlqen nëse provat eksperimentale e mbështesin atë. 8

Pra, astronomia moderne vërteton dhe konstaton se koha dhe materia u krijuan nga një Krijues përjetësisht i plotfuqishëm, i Cili është i pavarur nga këto të dyja. Fuqia e amshueshme që krijoi gjithësinë në të cilën ne jetojmë është Zoti, zotëruesi i fuqisë, dijenisë dhe urtësisë së pafund.

## **Fizika dhe Astronomia: Rënia e Idesë së një Gjithësie të Rastësishme dhe Zbulimi i Parimit Antropik**

Një dogmë e dytë ateiste që u zhvlerësua nga zbulimet e shekullit njëzet në astronomi është ideja e një gjithësie të rastësishme. Pikëpamja se e gjithë materia në gjithësi, trupat qiellor dhe ligjet që përcaktojnë raportet në mes tyre nuk është asgjë më shumë se rezultat i paqëllimtë i rastësisë është lëkundur në mënyrë dramatike.

Për herë të parë që prej viteve të 1970-ta, shkencëtarët kanë filluar të pranojnë se barazpesha fizike e gjithësisë është përshtatur në mënyrë të ndjeshme në dobi të jetës njerëzore. Përparimet e bëra në hulumtime u kanë mundësuar shkencëtarëve të zbulojnë se ligjet fizike, kimike dhe biologjike të gjithësisë, si edhe forca të tilla themelore si gravitacioni dhe elektro-magnetizmi dhe madje edhe vet strukturat e atomeve dhe të pjesëve të tij, të gjitha janë të rregulluara pikërisht ashtu si duhet të jenë për jetën njerëzore. Shkencëtarët Perëndimor këtë projektim të mrekullueshëm e kanë quajtur “parimi antropik”: Çdo aspekt i gjithësisë është projektuar duke pasur parasysh jetën njerëzore.

Karakteristikat e saj themelore mund t’i përmbledhim si vijon:

- Shpejtësia e zgjerimit të parë të gjithësisë (forca e shpërthimit të Big Bengut) ishte pikërisht shpejtësia e duhur. Sipas llogaritjeve të shkencëtarëve, po të kishte ndryshuar shkalla e zgjerimit nga vlera e saj aktuale për më shumë se një pjesë në një miliardë, gjithësia ose do të rënohej para se të arrinte madhësinë e saj të tanishme ose do të shpërndahej në çdo drejtim në atë mënyrë sa t’mos mund të ribashkohej më kurrë. Me fjalë të tjera, madje edhe në momentin e parë të ekzistencës së saj kishte një llogaritje të hollë të saktësisë prej një në një miliardë.

- Katër forcat fizike të gjithësisë (domethënë, forca gravitacionale, forca e dobët bërthamore, forca e fuqishme bërthamore dhe forca elektromagnetike) janë të gjitha në nivelet e duhura që të krijohet një gjithësi e rregullt dhe që jeta të ekzistojë. Madje edhe me luhatjet më të vogla të këtyre forcave (p.sh. një në  $10^{39}$  ose një në  $10^{28}$ ; domethënë – llogaritje në formë të vrazhdë – një në një

miliardë miliardë miliardë), gjithësia do të përbëhej ose vetëm prej rrezatimit ose vetëm prej hidrogjenit.

- Shumë përshtatje tjera delikate e bëjnë Tokën ideale për jetën njerëzore: madhësia e Diellit, largësia e tij nga Toka, karakteristikat unike fizike dhe kimike të ujit, gjatësia valore e rrezeve të diellit, mënyra se si atmosfera e Tokës përmban gazërat e domosdoshme për frymëmarrje dhe fusha magnetike e Tokës që i është përshtatur në mënyrë ideale jetës njerëzore. (Për më shumë informacion mbi këtë temë, shih librin *Krijimi i Gjithësisë* të Harun Jahjasë, Botuesit Al-Attique: 2001)

Kjo barazpeshë e brishtë është njëri prej zbulimeve më mahnitëse të astrofizikës moderne. Pol Dejvis, astronomi i mirënjohur, shkruan në paragrafin e fundit të *Planit kozmik* të tij: “Përshtypja e Projektimit është e pazëzueshme.” 9

Në një artikull në revistën *Nature*, astrofizikani V. Pres shkruan se **“ekziston një projektim madhështor në Gjithësi që favorizon zhvillimin e jetës inteligjente.”** 10

Është interesante se shumica e shkencëtarëve të cilët kanë bërë këto zbulime ishin materialist të cilët erdhën në këtë përfundim padëshirë. Ata nuk ndërmorën hetimet e tyre shkencore duke shpresuar të gjejnë dëshmi për Ekzistencën e Zotit. Por shumica, nëse jo të gjithë ata, përkundër mosdashjes së tyre, arritën në këtë përfundim si shpjegimi i vetëm për projektimin e mrekullueshëm të gjithësisë.

Në librin e tij *Gjithësia Simbiotike*, astronomi amerikan Xhorxh Grinstajni e pranon këtë fakt:

A thua si ka pasur mundësi të ndodhë kjo (që ligjet e fizikës t’ia përshtatin vetveten jetës)? ... Me shqyrtimin e të gjithë provave, vetvetiu lind mendimi se ndonjë ndërmjetës i mbinatyrshtëm – apo, më parë Ndërmjetësi – duhet të jetë i përfshirë. A është e mundshme që papritur, pa e pasur këtë qëllim, ne kemi marrë në thua në dëshminë shkencore të ekzistencës së një Qenie Supreme? A thua ishte Zoti i cili ndërhyri dhe kështu si me magji ndërtoi gjithësinë për të mirën tonë? 11

Duke e filluar pyetjen e tij me “A është e mundshme,” Grinstajni, një ateist, përpiqet të shpërfillojë faktin e qartë me të cilin përballej. Por shumë shkencëtarë të cilët iu kishin qasur kësaj çështjeje pa paragjykim pranojnë se gjithësia është krijuar posaçërisht për jetën njerëzore.

Materializmi tani është duke u konsideruar si një besim i gabueshëm jashtë sferës së shkencës. Gjeneticisti Amerikan Robert Grifits e pranon këtë kur thot: “Po të kemi nevojë për një ateist për të debatuar, shkoj në degën e filozofisë. Dega e fizikës nuk na hyn shumë në punë.” 12

Në librin *Fati i Natyrës: Si e zbulojnë ligjet e biologjisë qëllimin në gjithësi*, që trajton mënyrën se si ligjet fizike, kimike dhe biologjike janë të llogaritura në mënyrë të mahnitshme në mënyrë “ideale” duke patur parasysh nevojat për jetën njerëzore, biologu i mirënjohur molekular Majkëll Denton shkruan:

Pamja e re që është shfaqur në astronominë e shekullit njëzet paraqet një sfidë shqetësuese ndaj supozimit i cili ka qenë mbizotërues përbrenda qarqeve shkencore gjatë pjesës më të madhe të katër shekujve të kaluar: se jeta është një dukuri periferike dhe krejtësisht e rastit në planin kozmik.

13

Me pak fjalë, ideja e një gjithësie të rastësishme, ndoshta shtylla më qendrore e ateizmit, është vërtetuar si e pavlefshme. Shkencëtarët tani haptazi flasin për rënien e materializmit. 14 Zoti zbulon falsitetin e kësaj ideje në Kur’an: **“Ne nuk e krijuam qiellin e as tokën dhe çka ka në mes tyre pa qëllim. Ai është mendim i atyre që nuk besuan...”** (Kur’an, 38: 27), dhe shkenca e vërtetoi këtë të vërtetë në vitet e 1970-ta.

## Fizika e Kuantit dhe Zbulimi i Urtësisë Hyjnore

Një sferë e shkencës që shkatërron mitin materialist dhe jap dëshmi pozitive për teizmin është fizika e kuantit.

Fizika e Kuantit merret me grimcat më të vogla të materies, të quajtura poashtu “sfera nën-atomike.” Në shkollë, secili mëson se materia përbëhet prej atomeve. Atomët përbëhen nga një bërthamë dhe disa elektrone që sillen rreth tij. Një fakt i çuditshëm është se të gjitha këto grimca zënë vetëm diku rreth 0.0001 përqind të hapësirës së atomeve. Me fjalë të tjera, një atom është diçka që është 99.9999 përqind “i zbrazët.”

Ajo që është edhe më interesant, studimi i mëtejshëm tregon se bërthamat dhe elektronet përbëhen prej grimcave shumë më të vogla të quajtura “kuarkë,” të cilat në kuptimin fizik nuk janë madje as grimca; ato më parë janë thjeshtë energji. Ky zbulim theu dallimin klasik në mes të materies dhe energjisë. Tani duket se vetëm energjia ekziston në gjithësinë materiale dhe se materia është vetëm “energji e ngrirë.”

Ka edhe një fakt që ngjallë kureshtje edhe më shumë: Kuarkët, ato qeska energjie, veprojnë në atë mënyrë sa që mund të përshkruhen si “të vetëdijshme.” Fizikani Friman Dajson, kur mori Çmimin Tempëlton për Përparim në Fe (2000), pohoi se:

Atomët janë një gjë e çuditshme, që sillen më tepër si faktorë aktiv se sa si substanca inerte. Ato bëjnë zgjidhje të paparashikueshme në mes të mundësive alternative sipas ligjeve të mekanikës së kuantit. Duket se mendja, që manifestohet nga aftësia për të bërë zgjidhje, është deri në një masë një gjë e qenësishme në secilin atom. 15

Me fjalë të tjera, ekziston një informacion që qëndronë pas materies, informacion që i paraprinë sferës materiale. Gerald Shroeder, një shkencëtar i stërvitur në MIT i cili ka punuar si në fizikë ashtu edhe në biologji dhe është autor i librit *Shkenca e Zotit*, bën një numër komentesh të rëndësishme në lidhje me këtë çështje. Në librin e tij më të vonshëm, *Fytyra e fshehtë e Zotit: Shkenca zbulon të vërtetën përfundimtare*, Shroeder shpjegon se fizika e kuantit – bashk me degët tjera të shkencës – është mjeti për zbulimin e një urtësie universale që shtrihet pas botës materiale. Siç shprehet ai:

Njerëzimit iu deshtën me mijëra vite para se Ajnshtajni të zbuloj se, sado që duket e çuditshme, baza e materies është energjia, se materia është në të vërtetë energji e kondensuar. Mund t’na nevojitet një kohë më e gjatë që ta zbulojmë se ekziston ndonjë mos-qenie madje edhe më fundamentale se energjia që formon bazën e energjisë, e cila pastaj formon bazën e materies. 16

Xhon Arqibald Uiler, profesor i fizikës në Universitetin Princeton dhe fitues i Çmimit të Ajnshtajnit (2003), shpjegoi të njëjtin fakt kur tha se “bit-i” (shifra binare) e informacionit i jap nxitje “asaj,” substancës së materies. 17 Sipas Schroeder-it, kjo ka një “domethënie të thellë”:

Raportet materie/energji, funksionet e valëve të kuantit, kanë domethënie të thellë. Shkenca mund të jetë duke iu afruar kuptimit se e tërë gjithësia është një shprehje e informacionit, urtësisë, një ideje, pikërisht sikurse atomët që janë shprehje të prekshme të diçkaje të papeshë si energjia. 18

Kjo urtësi është një gjë aq e gjithëdijshme sa që e përfshinë tërë gjithësinë:

Një vetëdije e vetme, një urtësi universale, përshkon gjithësinë. Zbulimet e shkencës, ato që hulumtojnë natyrën e kuantit të materies nën-atomike, na kanë sjellur në cepin e një kuptimi

befasues: e tërë ekzistenca është shprehje e kësaj urtësie. Në laboratore ne e përjetojmë atë si informacion që së pari shprehet si energji dhe pastaj kondensohet në formën e materies. Çdo grimcë, çdo qenie, nga atomi deri te njeriu, duket të përfaqësojë një nivel të informacionit, të urtësisë. 19

Kjo don të thot se gjithësia materiale nuk është një grumbull i paqëllimtë dhe kaotik i atomeve, siç pretendon dogma ateiste/materialiste, por në vend të kësaj është një manifestim i urtësisë që ekzistoi para gjithësisë dhe që ka pushtet absolut mbi gjithçka që ekziston. Sipas fjalëve të Shroederit, është “sikur një bazë metafizike të ishte fiksuar mbi materialen.” 20

Ky zbulim shpartallon tërë mitin materialist dhe zbulon se gjithësia e dukshme materiale është vetëm një hije e një Qenie Absolute të mrekullueshme. Prandaj, siç e shpjegon Shroeder, fizika e kuantit është bërë pika në të cilën takohen shkencat dhe teologjia:

Pikëpamja e lashtë teologjike e gjithësisë është se e tërë ekzistenca është shfaqje e një urtësie të jashtëzakonshme, me një vetëdije universale që është pasqyrim i saj. Nëse e zëvendësoj fjalën informacion me urtësi, teologjia fillon të tingëllojë si fizikë e kuantit. Ndoshta po bëhemi dëshmitarë të bashkimit shkencor të materiales dhe shpirtërores. 21

Kuanti është vërtet pika në të cilën takohen shkencat dhe teologjia. Fakti se e tërë gjithësia përshkohet nga një urtësi u zbulua në Kur'an 14 shekuj më parë. Në një ajet lexojmë:

**I adhurari juaj është vetëm All-llahu, përveç Tij zot tjetër nuk ka. Dituria e Tij përfshinë çdo gjë. (Kur'an, 20:98)**

## **Shkencat natyrore: Rënia e Darwinizmit dhe Fitorja e “Projektimit Inteligjent”**

Siç u tha më heret, njëra prej mbështetjeve më themelore për ngritjen e ateizmit në zenitin e tij në shekullin e nëntëmbëdhjetë ishte teoria e evolucionit e Darvinit. Duke pohuar se origjina e qenieve njerëzore dhe e të gjitha gjallesave tjera mbështetet në mekanizmat e pavetëdijshëm natyror, Darwinizmi u dha ateistëve veshjen shkencore që ata kishin kërkuar me shekuj. Ateistët më të zjarrtë të asaj kohe përvetësuan teorinë e tij dhe mendimtarë si Karl Marksi dhe Fridrih Engelsi bënë shpjegimin e saj bazën e filozofisë së tyre. Lidhja në mes të Darwinizmit dhe ateizmit që lindi atëherë ka vazhduar deri në kohën tonë.

Por, në të njëjtën kohë, ky besim qendror i ateizmit është pikërisht ai që ka marrë goditjen më të madhe prej shkencës së shekullit njëzet. Zbulimet në paleontologji, biokimi, anatomi, gjenetikë dhe në fushat tjera shkencore kanë shpartalluar teorinë e evolucionit (Shih librin *Darvinizmi i hedhur poshtë* të Harun Jahjasë). Ne jemi marrë me këtë fakt shumë më hollësisht tjetërkund. Megjithatë, me pak fjalë, mund të themi si vijon:

- **Paleontologji:** Teoria e Darvinit mbështetet në supozimet se të gjitha speciet rrjedhin prej një paraardhësi të vetëm të përbashkët dhe se ato u ndanë prej njëra tjetrës gjatë një periudhe të gjatë kohore me anë të ndryshimeve të vogla graduale. Kinse, dëshmitë e nevojshme do të zbulohen në të dhënat fosile apo në mbetjet e ngurtësuar të gjallesave. Mirëpo, hulumtimi i fosileve i bërë gjatë shekullit njëzet paraqet një tablo krejtësisht të ndryshme, sepse asnjë fosil i qoftë një specie të padyshimtë të ndërmjetme, një specie që do ta vërtetonte këtë teori të evolucionit gradual në mes të specieve, nuk është gjetur. Për më tepër, çdo takson (kafshë apo bimë që ka lidhje natyrore) shfaqet papritur në të dhënat fosile dhe kurrë nuk është gjetur asnjë gjurmë e çfarëdo paraardhësi të mëparshëm. Dukuria e njohur si Shpërthimi i Kambrianit, të cilën shkencëtarët e klasifikojnë si një

periudhë kohe që u shfaq 540 deri 490 milionë vite më parë, është në veçanti interesante. Në atë periudhë të hershme gjeologjike, gati e gjithë fila e mbretërisë shtazore (grupet më të mëdha me struktura trupore mjaft të ndryshme) u shfaqën papritur. Shfaqja e papritur e shumë kategorive të ndryshme të gjallesave me struktura trupore tërësisht të ndryshme dhe organe dhe sisteme jashtëzakonisht komplekse (p.sh. moluskët, antropodët, ekinodermët dhe, siç është zbuluar së voni, madje edhe kurrizorët) e bënë të pavlefshme teorinë e evolucionit dhe vërtetuan krijimin, sepse siç pajtohen edhe evolucionistët, shfaqja e papritur e një taksoni nënkupton projektimin e qëllimshëm dhe kjo don të thotë krijim.

- **Vrojtimet biologjike:** Darvini shtjelloi në mënyrë të hollësishme teorinë e tij duke u mbështetur në shembujt se si shumuesit e kafshëve prodhuan lloje të ndryshme të qenëve apo kuajve. Ai ekstrapoloi ndryshimet e kufizuara që vrojtoi për tërë botën natyrore dhe sugjeroi se çdo gjallesë mund të kishte rrjedhur nga një paraardhës i përbashkët. Por Darvini pohoi kështu në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur niveli i sofistikimit shkencor ishte i ulët. Në shekullin e njëzet, gjërat ndryshuan shumë. Dekada vrojtimesh dhe eksperimentesh në speciet e ndryshme shtazore kanë treguar se ndryshimi në gjallesa kurrë nuk ka tejkaluar një kufi të caktuar gjenetik. Pohimet e Darvinit, si: “Nuk e shoh ndonjë vështirësi që një racë arinjësh të jetë shëndrruar, me anë të seleksionimit natyror, gjithnjë e më shumë në shtazë ujore sa i përket shprehive të tyre, me gojë gjithnjë e më të mëdha, derisa një krijesë është bërë aq monstruoze sa një balenë” 22 në të vërtetë dëshmon mosdijeninë e tij të madhe. Në anën tjetër, vrojtimet dhe eksperimentet tregojnë se mutacionet e definuara nga Neo-Darvinizmi si një mekanizëm evolutiv nuk u shtojnë asnjë informacion gjenetik krijesave të gjalla.

- **Zanafilla e Jetës:** Darvini foli për paraardhësin e përbashkët, por kurrë nuk e përmendi se si erdh në jetë ky person. Supozimi i tij i vetëm ishte se qeliza e parë mund të ishte formuar si rezultat i reaksioneve të rastësishme kimike “në ndonjë pellg të vogël të nxehtë.” 23 Por ata biokimist evolucionist të cilët u përpoqën që të mbyllin këtë vrimë në Darwinizëm ishin të frustruar nga fakti se të gjitha vrojtimet dhe eksperimentet e tyre tregonin se asnjë qelizë e gjallë nuk mund të krijohej nga materia e pajetë me anë të reaksioneve të rastësishme kimike. Madje edhe astronomi ateist anglez Fred Hojl u shpreh se një skenar i tillë “është i krahasueshëm me mundësinë që një uragan që përshkon një depo hekurinash nga materialet që gjinden aty të mund të montonte një Boing 747.” 24

- **Projektimi inteligjent:** Shkencëtarët të cilët i studiojnë qelizat dhe molekulat e tyre, bashkë me organizimin e mrekullueshëm brenda trupit dhe rregullin dhe planin e brishtë të organeve të trupit, ballafaqohen me provën që evolucionistët dëshirojnë ta hedhin poshtë me forcë: Bota e gjallesave përshkohet prej projekteve tejet komplekse që nuk mund të gjinden në asnjë pajisje teknologjike. Shembuj të ndërlikuar të projektimit, duke përfshirë sytë tonë që janë shumë më superior se çfarëdo kamere, krahët e zogjve që kanë frymëzuar teknologjinë e fluturimit, sistemi i integruar në mënyrë komplekse i qelizave të gjallesave dhe të dhënat e mrekullueshme të ruajtura në ADN kanë zhvleftësuar teorinë e evolucionit, e cila i konsideron gjallesat si produkt të rastësisë së verbër.

Nga fundi i shekullit njëzet, të gjitha këto fakte e kanë mbështetur Darwinizmin për muri. Sot, në SHBA dhe në shtetet tjera Perëndimore, teoria e projektimit inteligjent po pranohet gjithnjë e më shumë nga shkencëtarët. Ata që e mbrojnë atë thonë se Darwinizmi ka qenë një gabim i madh në historinë e shkencës dhe ai u bë i tillë duke e imponuar filozofinë materialiste në modelin shkencor.

Zbulimet shkencore tregojnë se ekziston një projektimi në gjallesa, i cili vërteton krijimin. Me pak fjalë, shkenca provon përsëri se Zoti krijoi të gjitha gjallesat.

## **Psikologji: Rënia e Frojdianizmit dhe Pranimi i Besimit**

Përfaqësuesi i ateizmit të shekullit njëzet në psikologji ishte psikiatri austriak Zigmund Frojdi (1856-1939). Ai paraqiti një teori psikologjike që përjashtonte ekzistencën e shpirtit dhe u përpoq të shpjegonte gjithë botën shpirtërore të njerëzimit në lidhje me motivime seksuale dhe të ngjashme hedonistike. Por sulmi më i madh i Frojdit drejtohej kundër religjionit. Në librin e tij *E ardhmja e një iluzioni*, fillimisht të botuar në vitin 1927, Frojdi sugjeroi se besimi fetar ishte një lloj sëmundjeje mendore (neurozë) që do të zhdukej plotësisht me përparimin e njerëzimit. Për shkak të kushteve primitive shkencore të asaj kohe, teoria e tij u propozua ose pa hulumtimin dhe hetimin e duhur ose pa ndonjë literaturë shkencore apo mundësi krahasimi. Prandaj, pohimet e tij ishin tejet të mangëta.

Pas Frojdit, psikologjia u zhvillua në një themel ateist. Veç kësaj, themeluesit e shkollave të tjera të psikologjisë ishin ateist të pasionuar. Dy prej këtyre ishin B.F. Skinner (1904-90), themelues i shkollës biheviortike dhe Albert Ellis (1913-), themelues i terapisë racionale- emotive. Bota e psikologjisë gradualisht u bë tribunë e ateizmit. Një sondazh i vitit 1972 i bërë midis anëtarëve të Shoqatës Psikologjike Amerikane zbuloi se vetëm 1.1 përqind e psikologëve në këtë vend kishin ndonjë besim fetar. 25

Por shumica e psikologëve të cilët ranë në këtë mashtrim të madh u përgënjeshtroan nga vet hulumtimet e tyre psikologjike. Supozimet themelore të Frojdianizmit u tregua se nuk kanë gadi kurrfarë mbështetje shkencore. Veç kësaj, u dëshmuar se religjioni nuk ishte sëmundje mendore, siç deklaruan Frojdi dhe disa teoricien tjerë të psikologjisë, por më tepër një element themelor i shëndetit mendor. Patrik Glin përmbledh kështu këto zhvillime të rëndësishme:

Mirëpo çereku i fundit i shekullit njëzet nuk ka qenë i mirë për vizionin psikoanalitik. Gjëja më e rëndësishme ka qenë shfaqja e pikëpamjeve të Frojdit për religjionin si krejtësisht të gabuara. Është mjaft ironike që hulumtimet shkencore në psikologji gjatë njëzet e pesë viteve të fundit kanë dëshmuar se, larg prej të qenit neurozë apo burim i neurozës siç pretendonin Frojdi dhe pasuesit e tij, besimi fetar është njëri prej korelatëve (lidhjeve) më të qëndrueshme të shëndetit të përgjithshëm mendor dhe të lumturisë. Studim pas studimi kanë treguar një lidhje të fuqishme në mes të besimit fetar dhe praktikës, në njërin anë dhe sjelljeve të shëndosha në lidhje me problemet si vetëvrasia, alkoholi dhe keqpërdorimi i narkotikëve, ndarja bashkëshortore, depresioni, madje, mbase befasuese, nivelet e kënaqjes seksuale në martesë, në anën tjetër. Me pak fjalë, të dhënat empirike lëvizin krejtësisht në drejtim të kundërt me konsensusin gjoja “shkencor” të profesionit psikoterapeutik. 26

Në fund, siç thot Glin, “psikologjia moderne në mbarim të shekullit të njëzet duket se po rinjoftohet me religjionin,” 27 dhe “një pikëpamje tërësisht laike e jetës mendore të njeriut është dëshmuar të jetë e dështuar jo vetëm në rrafshin teorik, por edhe në rrafshin praktik.” 28

Me fjalë të tjera, psikologjia poashtu ka çrrënjësuar ateizmin.

## **Mjekësia: Zbulimi se si “Zemrat gjejnë prehje”**

Një degë tjetër e shkencës që u ndikua nga dështimi i supozimeve ateiste ishte mjekësia.

Sipas rezultateve të përpiluara nga Dejvid B. Larson dhe ekipi i tij në Institutin Kombëtar për Kërkime Shëndetësore, një krahasim në mesin e amerikanëve në lidhje me respektimin e detyrave fetare nga ana e tyre dha rezultate shumë interesante. Rreziku që meshkujt të cilët shkonin në kishë shpesh të sëmurën prej sëmundjeve arteriosklerotike të zemrës ishte vetëm 60 përqind në krahasim me atë të meshkujve të cilët nuk shkonin në kishë rregullisht; në mesin e femrave, vetëvrasja ishte dyfish më e lartë tek femrat që nuk shkonin rregullisht në kishë se sa tek ato që shkonin në kishë rregullisht; duhanpirësit të cilët e konsideronin religjionin shumë të rëndësishëm në jetërat e tyre kishin gjasa mbi shtatë herë më të mëdha të kenë lexime normale të shtypjes diastolike se sa ata të cilët nuk e konsideronin të rëndësishëm. 29

Psikologët laik shpjegojnë dukuri të tilla përgjithësisht si dukuri që kanë shkaqe psikologjike. Në këtë kuptim, besimi fetar ngritë moralin e një personi dhe kontribon në mirëqenien e tij apo të saj. Mund të ketë diç të vërtetë në këtë shpjegim, por nëse e shikojmë më për së afërmi, vërejmë diç shumë më befasuese: Besimi në Zot është shumë më i fuqishëm se çfarëdo ndikimi tjetër në moralin e njeriut. Në hulumtime gjithëpërfshirëse për lidhjen në mes të besimit fetar dhe shëndetit fizik, Dr. Herbert Benson i Shkollës Mjekësore të Harvardit doli me disa rezultate interesante. Edhe pse nuk posedon besim fetar, Bensoni erdh në përfundimin se besimi në Zotin dhe adhurimi kishte efekt shumë më pozitiv në shëndetin njerëzor se që mund të vërehet në çkado tjetër. Bensoni konkludon se ka “zbuluar se besimi fetar qetëson mendjen si asnjë formë tjetër e besimit.” 30

Pse ekziston një lidhje aq e posaçme në mes të besimit fetar, shpirtit njerëzor dhe trupit? Bensoni, një hulumtues laik, konstatoi se mendja dhe trupi njerëzor janë të “lidhura me Zotin.” 31

Ky fakt, të cilin bota e mjekësisë ngadalë po fillon ta vërejë, është një fshehtësi e zbuluar në Kur'an: **“Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen. Pra, ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen.” (Kur'an, 13:28)** Arsyeya pse ata të cilët besojnë në Zot, i falen Atij dhe kanë besim në Të janë më të shëndoshë fizikisht dhe mentalisht se të tjerët është se ata sillen në harmoni me natyrën e tyre. Sistemet filozofike që janë në kundërshtim me natyrën e njeriut gjithnjë sjellin me vete dhimbje, pikëllim, shqetësim dhe dëshprim.

Burimi themelor i qetësisë së njerëzve fetar është se ata veprojnë për të fituar pëlqimin e Zotit. Me fjalë të tjera, kjo prehje është rezultat i natyrshëm i dëgjimit të zërit të ndërgjegjës së njeriut. Njerëzit të cilët i jetojnë parimet morale të fesë thjeshtë “për të qenë më të qetë” apo “për të qenë më të shëndoshë” nuk mund të jetojnë në harmoni me parimet morale të fesë; ata që veprojnë me këtë qëllim nuk mund të gjejnë prehje në kuptimin e saj të vërtetë. Zoti e di mirë se çfarë mbajnë njerëzit në zemrat e tyre dhe atë që ata shfaqin. Qetësia e mendjes vie vetëm duke qenë i sinqertë dhe duke u përpjekur për të fituar pëlqimin e Zotit. Zoti urdhëron:

**Përqënro vetveten tënde sinqerisht në fenë (e vërtetë), i larguar prej çdo të kote, (e ajo fë), feja e All-llahut në të cilën Ai i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu. Ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Kur'an, 30:30)**

Nën dritën e këtyre zbulimeve, mjekësia moderne po fillon të bëhet më e vetëdijshme për këtë të vërtetë. Siç thot Patrik Glin, “mjekësia bashkëkohore është qartë duke lëvizur në drejtim të pranimit të përmasave të shërimit përtej natyrës thjeshtë materiale.” 32

## **Shoqëria: Rënia e Komunizmit, Fashizmit dhe Ëndrrës Hipi**

Rënia e ateizmit nuk ndodhi vetëm në astrofizikë, biologji, psikologji dhe mjekësi; ajo ndodhi poashtu në politikë dhe në parimet morale të shoqërisë.

Rënia e komunizmit mund të konsiderohet si njëri prej shembujve më të rëndësishëm në lidhje me këtë. Komunizmi mund të konsiderohet rezultati politik më i rëndësishëm i ateizmit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Themeluesit e kësaj ideologjie, Marksi, Engelsi, Vladimir Lenini (1870-1924), Leon Trocki (1879-1940), apo Mao Cedung (1893-1976), të gjithë pranuan ateizmin si një parim themelor. Qëllimi primar i të gjitha regjimeve komuniste ishte të prodhojnë shoqëri ateiste dhe të shkatërrojnë besimin fetar. Bashkimi Sovjetik i Stalinit, Kina komuniste e Maos, Kamboxha, Shqipëria dhe disa shtete të bllokut të lindjes zbatuan presion të pamasë në Muslimanët dhe njerëzit e tjerë fetar, ndonjëherë deri në atë shkallë sa të kryejnë vrasje masive.

Mirëpo, për çudi, në fund të viteve të 1980-ta, ky sistem i përgjakshëm ateist u rrëzua. Kur i shqyrtojmë arsyet e kësaj rënie dramatike, shohim se ajo që u rrëzua ishte në të vërtetë ateizmi. Patrik Glin shkruan:

Për të qenë të sigurt, historianët laik do të thoshin se gabimi më i madh i komunizmit ishte përpjekja për të sfiduar ligjet e ekonomisë. Por ligjet tjera, gjithashtu, hynë në lojë ... Veç kësaj, me kuptimin e rrethanave të rrëzimit të komunizmit nga ana e historianëve, po bëhet gjithnjë e më e qartë se elita sovjetike ishte vet duke përjetuar agoninë e një “krize të besimit” ateist. Duke qenë se kishte jetuar nën një ideologji ateiste – një ideologji që përbëhej prej gënjeshtrave dhe që bazohej në një “Gënjeshtër të Madhe” – sistemi sovjetik përjetoi një demoralizim radikal në çdo kuptim të kësaj fjale. Populli, duke përfshirë edhe elitën sunduese, humbi gjithë ndjenjën e parimeve morale dhe gjithë ndjenjën e shpresës. 33

Një tregues interesant i “krizës së madhe të besimit” të sistemit sovjetik ishte përpjekja e Presidentit Mihajl Gorbaçov (1931-) për të bërë reforma. Që prej se ai u bë sekretar i përgjithshëm i partisë komuniste (1985-91) dhe mori presidencën sovjetike në vitin 1990, Gorbaçovi ishte i interesuar për problemet morale si edhe për reformat ekonomike. Për shembull, një prej gjërave të para që ai bëri ishte të fillojë një fushatë kundër alkoholizmit. Për të ngritur moralin e shoqërisë sovjetike, ai përdori për një kohë të gjatë terminologjinë marksiste-leniniste. Por duke e parë se kjo nuk sjellte kurrfarë dobie, ai madje filloi ta përmendte Zotin në disa prej fjalimeve të tij edhe pse ishte një ateist. Natyrisht, këto fjalë jo të singerta të besimit nuk sollën kurrfarë dobie dhe kriza e besimit në shoqërinë sovjetike vazhdoi të keqësohej. Përfundimisht, perandoria gjigante sovjetike u rrëzua në vitin 1991.

Shekulli i njëzet shënoi jo vetëm rrëzimin e komunizmit, por gjithashtu edhe atë të fashizmit, një frut tjetër i filozofisë anti-fetare të shekullit njëzet. Fashizmi është rezultat i një filozofie që mund të quhet përzierje e ateizmit dhe paganizmit dhe është shumë armiqësor ndaj religjioneve teiste. Fridrih Niçe (1844-1900), i cili mund të quhet babai i fashizmit, lartësoi parimet morale të shoqërive barbare idhujtare, sulmoi Krishtërimin dhe religjionet tjera monoteiste dhe madje e quajti veten “Anti-Krisht.”

Pasuesi i tij, Martin Hajdeger (1889-1976), ishte një përkrahës nacist i etshëm dhe idetë e këtyre dy mendimtarëve ateist i dhanë vull egërsisë së Gjermanisë nacistë. Lufta e dytë botërore, e

cila shkaktoi vdekjen e 55 milionë njerëzve, është një shembull tjetër i fatkeqësisë që ideologji të tilla ateiste si fashizmi dhe komunizmi i kanë sjellur njerëzimit.

Në këtë pikë, duhet ta sjellim ndër mend Darwinizmin Social, një tjetër ideologji ateiste që ndihmoi në shkaktimin e të dy luftërave botërore. Në veprën e tij *Evropa që nga viti 1870*, profesori i historisë në Harvard Xhejms Xholi pohon se prapa secilës prej dy luftërave botërore qëndrojnë pikëpamjet filozofike të udhëheqësve Evropian Social Darwinist të cilët besonin në mitin se lufta ishte një domosdoshmëri biologjike dhe se kombet zhvilloheshin nëpërmjet konfliktit. 34

Një pasojë tjetër shoqërore e ateizmit u shfaq në demokracitë Perëndimore. Në ditën e sotme, ekziston një tendencë që Perëndimi të konsiderohet si “bota e Krishterë.” Mirëpo, që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, një kulturë ateiste që rritej me shpejtësi kishte ndikim në kulturën e Krishterë dhe sot ekziston një konflikt në mes tyre në atë që quajmë qytetërimi Perëndimor. Dhe ky element ateist ishte shkaktari i vërtetë i imperializmit Perëndimor, degjenerimit moral, despotizmit dhe dukurive tjera negative.

Në veprën e tij *Zoti: Dëshmia*, shkrimtari Amerikan Patrik Glin tërheq vëmendjen ndaj kësaj çështjeje dhe për të bërë krahasimin në mes të elementeve që ndjejnë frikë ndaj Zotit dhe atyre ateiste në Perëndim, merr shembujt e revolucioneve amerikane dhe franceze. Revolucioni Amerikan është realizuar prej njerëzve të cilët besonin në Zot. Deklarata e Pavarësisë së Amerikës shpall se të gjithë njerëzve “Krijuesi i tyre ju ka dhuruar disa të drejta të patjetërsueshme.” Pasiqë revolucioni francez ishte vepër e ateistëve, Deklarata Franceze e të Drejtave të Njeriut dallonte, nuk përmendte Zotin dhe ishte përplot me nocione ateiste dhe neo-pagane.

Përfundimet faktike të dy revolucioneve ishin krejtësisht të ndryshme: në modelin Amerikan, u krijua një mjedis relativisht më paqësor dhe më tolerant, që respektoi fenë dhe besimin fetar; në Francë, armiqësia e egër ndaj fesë përmbyti vendin në gjak dhe liroi një egërsi që nuk kishte të barabartë në historinë franceze deri në atë kohë. Siç thot Glin, “ekziston një lidhje reciproke interesante në mes të ateizmit në njërin anë dhe katastrofës politike në anën tjetër.” 35

Glin vëren se përpjekjet për ta shëndrruar Amerikën në një vend ateist poashtu i kanë shkaktuar dëm shoqërisë. Fakti se revolucioni seksual, për shembull, që u përhap gjatë viteve të 1960-ta dhe 1970-ta u shkaktoi dëm jashtëzakonisht të madh vlerave tradicionale morale pranohet madje edhe prej historianëve laik. 36

Lëvizja hipi ishte një shfaqje e këtij dëmi shoqëror. Hipit besonin se mund të gjenin emancipim shpirtëror nëpërmjet filozofisë laike humaniste, filozofive të lindjes dhe me anë të gjërave të tilla si narkotikët dhe seksi i pakufizuar. Këta njerëz të rinjë që vërshuan rrugët me këngë romantike – si ajo *Imagjino* e Xhon Lenonit, që doli në shitje në vitin 1971 dhe në të cilën ai foli për një botë “pa shtete dhe pa fe poashtu” – në të vërtetë po pësonin një mashtrim masiv.

Në të vërtetë, një botë pa fe i solli ata faktikisht në një fund fatkeq. Udhëheqësit hipi të viteve të 1960-ta ose bënë vetëvrasje ose vdiqën prej gjendjeve komatoze të shkaktuara nga narkotikët në fillim të viteve të 1970-ta. Shumë hipi të tjerë të rinjë pësuan fat të ngjashëm.

Pjesëtarët e të njëjtës gjeneratë të cilët përdorën dhunën u gjendën në anën që u bë viktimë e dhunës. Gjenerata e vitit 1968, e cila ia ktheu shpinën Zotit dhe religjionit dhe paramenduan se do të mund të gjenin shpëtimin në koncepte të tilla si revolucioni apo Epikuranizmi egoist, shkatërruan si veten ashtu edhe shoqëritë e tyre.

## Lëvizja drejt parimeve morale fetare

Faktet e dhëna më lartë dëshmojnë qartë se ateizmi është duke pësuar rënie të paevitueshme. Me fjalë të tjera, njerëzimi është – dhe do të jetë – duke u kthyer nga Zoti dhe jo vetëm në komunitetet shkencore dhe politike. Prej burrave të spikatur të shtetit e deri te yjet e filmit dhe artistët e popullarizuar, ata të cilët kanë ndikim në opinion në Perëndim janë shumë më fetar se që ishin më parë. Shumë njerëz e kanë kuptuar të vërtetën dhe fillojnë të besojnë në Zot pasi që kanë jetuar me vite të tëra si ateist. (Patrik Glin, prej librit të të cilit kemi cituar, është njëri prej këtyre ish-ateistëve.)

Është interesante se zhvillimet që kontribuan në këtë përfundim filluan poashtu në gjysmën e dytë të viteve të 1970-ta. Parimi antropik së pari u shfaq në vitet e 1970-ta dhe kriticizmi shkencor i Darwinizmit filloi të shprehej në mënyrë të zëshme në të njëjtën kohë. Pika kthesë kundër dogmës ateiste të Frojdit ishte vepra *Rruga më pak e rrahur* e M. Skot Pek. Për këtë arsye, Glin, në botimin e vitit 1997 të librit të tij, shkruan se “gjatë njëzet e pesë viteve të fundit, kanë dalë në shesh dëshmi të rëndësishme, që shkatërrojnë themelet e botëkuptimit bashkëkohor laik që dominoi për një kohë të gjatë.” 37

Padyshim, fakti që botëkuptimi ateist është tronditur në themel nënkupton se një tjetër botëkuptim po ngritet, e ai është besimi në Zotin. Që nga fundi i viteve të 1970-ta (ose që nga fillimi i shekullit të katërmëdhjetë sipas kalendarit Musliman), bota ka qenë dëshmitare e ngritjes së vlerave fetare. Sikurse edhe proceset tjera shoqërore, pasiqë ai zhvillohet gjatë një periudhe të gjatë kohore e jo përnjëherë, shumica e njerëzve mund t’mos e vërejnë atë. Mirëpo, ata të cilët e vlerësojnë këtë zhvillim pak më me kujdes shohin se bota është një pikë kthese madhore në sferën e ideve.

Historianët laik përpiqen ta shpjegojnë këtë proces sipas parimeve vetjake të tyre. Megjithatë, duke qenë se ata janë në lajthitje të thellë sa i përket ekzistencës së Zotit, ata poashtu gabojnë shumë në lidhje me rrjedhën e historisë. Në të vërtetë, siç shpallet në vargun në vijim, historia lëvizë ashtu siç e ka përcaktuar Zoti: **“Në ligjin e All-llahut kurrë nuk do të hasësh ndryshim. Në ligjin e All-llahut kurrë nuk do të hasësh devijim.”** (Kur’an, 35:43) Për të vazhduar pastaj se historia ka një qëllim dhe shpaloset ashtu siç ka urdhëruar Zoti. Dhe urdhëri i Zotit është të përsosë dritën e Tij:

**Ata përpiqen me gojët e tyre ta shuajnë dritën e All-llahut, e All-llahu nuk do tjetër, pos ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë. (Kur’an, 9:32)**

Me fjalë të tjera, Zoti ia ka zbritur dritën e Tij njerëzimit përmes fesë që Ai ka shpallur: Islamit. Ata të cilët nuk besojnë duan ta shuajnë këtë dritë me “gojë” e tyre – aludimet, propagandën dhe filozofitë, por Zoti përfundimisht do ta përsosë dritën e Tij dhe do të bëjë që vlerat fetare të mbisundojnë.

## **Përfundim**

Ne jemi duke jetuar në një kohë të rëndësishme. Ateizmi, të cilin njerezit janë përpjekur për qindra vite ta paraqesin si “rrugë të arsyes dhe shkencës,” po vërtetohet të jetë thjeshtë mungesë e arsyes dhe mosdijeni. Filozofia materialiste, e cila u përpoq ta përdor shkencën për qëllimet e saj vetjake, është mposhtur nga shkencën. Një botë që e shpëton veten nga ateizmi do të kthehet drejt Zotit dhe fesë. Mirëpo, nga cila fe do të kthehet? Me lejen e Zotit, ajo fe do të jetë Islami. Siç do të shohim në kapitujt pasues, ky proces ka filluar shumë kohë më parë.

Është e qartë se Muslimanët kanë detyra të rëndësishme në këtë periudhë. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë ndryshim të madh në mënyrën e të menduarit në botë, ta interpretojnë atë, t'i përdorin në mënyrën më të mirë rastet dhe mundësitë e ofruara nga globalizimi dhe ta përfaqësojnë me efikasitet të vërtetën përgjatë kësaj rruge. Ata duhet ta dinë se konflikti themelor i ideve është në mes të ateizmit dhe besimit. Nuk është kjo një luftë në mes të Lindjes dhe Perëndimit, sepse këto të dyja përmbajnë besimtarë dhe ateistë. Për këtë arsye, të Krishterët besnik dhe Çifutët besnik janë aleat të Muslimanëve. Mosmarrëveshja kryesore nuk qëndron në mes Muslimanëve dhe Ithtarëve të Librit (Çifutët dhe të Krishterët), por në mes të Muslimanëve dhe Ithtarëve të Librit në njërin anë dhe ateistëve dhe paganëve në anën tjetër. Natyrisht se ne nuk duhet të shfaqim armiqësi ndaj njerëzve të tillë; në vend të kësaj, ne duhet t'i konsiderojmë ata si njerëz që kanë nevojë të shpëtohen nga lajthitja e tyre.

Koha kur shumë njerëz të cilët janë duke jetuar në mosdije pa asnjë dijeni për parimet morale fetare do të stolisen me besim në botën e afërt post-ateiste është duke u afruar shpejtë.

## Kapitulli 2

### Përhapja e vrullshme e Islamit në Amerikë 50

Në kapitullin e mëparshëm, rrëfyem se njerëzit po fillonin t' mos e pranonin ateizmin dhe t'i kthehen fesë dhe pyetëm se cilën fe po kërkonin ata. Numri në rritje i njerëzve që kthehen në Islam në disa vitet e fundit tregon se përgjigja e saktë në këtë pyetje ka filluar të zbulohet. Çdo ditë, interesimi për Islamin po rritet në mbarë botën dhe shumë njerëz po kthehen në Islam pasi që po e lexojnë Kur'anin dhe po e studiojnë jetën e Pejgamberit Muhammed (saas). Veç kësaj, ka njerëz të cilët ndoshta nuk kanë filluar ende ta praktikojnë Islamin por që janë të ndikuar shumë nga mësimet morale të Kur'anit dhe thonë se mënyra më e mirë e jetës për qeniet njerëzore është ajo e përshkruar në Kur'an.

Tridhjetë apo dyzet vite më parë, pjesa më e madhe e njerëzve nuk dinin gadi asgjë për Islamin; tani, Islami është bërë religjioni më i përfolur, religjioni për të cilin shkruhet dhe hulumtohet më së tepërmi në botë, si edhe religjioni për të cilin përgatiten shumica e programeve. Natyrisht, kjo gjendje e gjërave ka kontribuar që shoqëria të mësojë për Islamin. Në njërin anë, ata që janë të përfshirë në aktivitete të tilla kanë zgjeruar dijeninë e tyre për Islamin; në anën tjetër, atyre të cilëve u është drejtuar ky informacion mund ta kenë shfrytëzuar rastin që për herë të parë në jetën e tyre të fitojnë dijeni për Islamin. Pra, për shkak të mungesës së informimit apo informimit të gabuar njerëzit të cilët kanë pasur pak kontakt me Islamin po hyjnë në këtë fe në turma.

Kjo lëvizje vërehet mjaft në Shtetet e Bashkuara, një vend i bazuar në vlera fetare. Kur Amerikanët flasin për vendin e tyre, njëra prej gjërave që ata theksojnë është se njerëzit e çdo përkatësie fetare janë të lirë të jetojnë në paqe dhe siguri. Kjo rrethanë u ka dhënë emigrantëve Muslimanë një vend ku mund të praktikojnë fenë e tyre të lirë dhe të flasin për besimin e tyre. Si rezultat i kësaj, numri i Muslimanëve rritet përditë. Përkundër kësaj, Muslimanët me vite të tëra kanë mbetur të pakët në numër dhe ekonomikisht dhe politikisht të dobët.

Por gjatë 10 viteve të fundit, këto vështirësi ekonomike, shoqërore dhe politike kanë filluar të zhduken. Në disa shtete, xhamitë ekzistuese janë të stërmushura dhe janë ndërtuar xhami të reja. Me qindra shkolla Islamike, që punojnë me orar të plotë dhe gjatë fundjavës, janë hapur dhe është dashur të zgjerohen për të regjistruar të gjithë ata që duan të regjistrohen. Shumë kompani kanë filluar të veçojnë dhoma për të punësuarit e tyre Musliman, shumë banka kanë filluar të hapin sektorë që veprojnë sipas ligjit Islamik dhe shumë institucione shtetërore kanë filluar të punësojnë Muslimanë në poste të larta.

Një botim i vonshëm i revistës *Krishtërimi Sot*, njëres prej revistave më të njohura të Amerikës përmbante një artikull të titulluar "A janë të Krishterët të përgatitur për Muslimanët në rrjedhën e përgjithshme?" Ky artikull bën këtë vlerësim të ngritjes së Islamit në Amerikë:

Islami mund të bëhet religjioni i dytë më i madh në Amerikë aty nga viti 2015, duke ia kaluar Judeizmit, sipas disa vlerësimeve. Sipas vlerësimeve tjera, Islami tashmë ka arritur atë shkallë.

Muslimanët po e ndryshojnë pamjen kulturore dhe fetare duke shkuar në Perëndim. Një spital në Detroit u ofron pacientëve Muslimanë kopje të Kur'anit; Aeroporti Ndërkombëtar i Denverit ka një faltore ku Muslimanët mund të falen; Senati i SHBA-ve ka ftuar një klerik Musliman për të hapur seancën e tij me lutje; forcat ushtarake kanë punësuar katër kapelan Musliman; Shtëpia e Bardhë dërgon urime (sikurse kartpostalet e saj të Kërshëndellave) për Fitër Bajram, festën që

shënon përfundimin e Ramazanit; Ambasada e Arabisë Saudite në Uashington D.C. u dërgon nga 100 Kur'an në muaj burgjeve ndërsa imamët (udhëheqësit shpirtëror) dërgojnë vullnetarë për mësimin e Arabishtes. “Në Kapitol Hill ... shërbimet e përjavshme të lutjeve dhe forumet Muslimane për t’ua bërë të njohura kongresistëve pikëpamjet Muslimane janë bërë një gjë e zakonshme,” shkruan Ira Rifkin e Shërbimit të Lajmeve Fetare (30 Nëntor 1999), “dhe në Kongres është paraqitur një faturë për të botuar një pullë postale që përkujton Ramazanin.” 38

Këto zhvillime mahnitëse kanë tërhequr interesimin e shumë sociologëve. Një nga emrat më të rëndësishëm që është i lidhur me këtë çështje është Profesori Dianë Ek, e njohur për sajimin e emrit “Projekti i Pluralizmit” për një iniciativë për dialogun ndërfaqet. Në librin e saj, *Një Amerikë e re fetare*, ajo jap një vlerësim për përfundimin në të cilin ka arritur ajo në lidhje me ngritjen e shpejtë të Islamit:

Me rritjen në numër të Muslimanëve dhe me bërjen e tyre më të dukshëm në shoqërinë Amerikane, zyrtarët publik kanë filluar të mos flasin më për “kisha dhe sinagoga” por për “kisha, sinagoga dhe xhami.” Zbatimi vjetor i muajit të Ramazanit të agjërimit Musliman tani njoftohet publikisht dhe bëhet arsye për përshkrimet e Muslimanëve fqinjë në *Dallas Morning News* ose *Minneapolis Star Tribune*. Vaktet që shënojnë përfundimin e agjërimit të quajtura “yftarë” në përfundim të secilës ditë janë bërë momente identifikimi. Në fund të viteve të 1990-ta kishte organizime të yftarit nga personeli Musliman në Kapitol Hill, në Pentagon dhe në Departamentin e Shtetit. Në vitin 1996 Shtëpia e Bardhë ishte mikpritëse e organizimit të parë të festimit të Fitër Bajramit në fund të muajit të Ramazanit, një praktikë që ka vazhduar. Poashtu në të njëjtin vit Marina e SHBA-ve gradoi kapelanin e parë Musliman, Togerin M. Malak Abd al-Muta’ Ali Noel dhe në vitin 1998 u hap xhamia e parë e Marinës së SHBA-ve në Bazën Detare të Norfolkut në Virgjina, ku ishte i stacionuar Togerin Noel. Kur 50 marinarë marrin pjesë në faljen e së Premtes (Xhumasë) në këtë vend, ata na bëjnë me dije të gjithë neve për fillimin e një epoke të re të jetës fetare Amerikane. 39

Ek i konsideron këto zhvillime si shenjë të fillimit të një epoke të re, në të cilën Islami do të përhapet shpejtë, jo vetëm në mbarë Amerikën por në mbarë botën.

## Zhvillimet pas 9/11

Interesimi Amerikan për Islamin arriti kulmin e vet në çerekun e fundit të vitit 2001. Arsyeja më e rëndësishme për këtë ishin sulmet e 9/11 kundër Qendrës Botërore të Tregtisë dhe Pentagonit. Disa studime të ndërmarra për të përcaktuar rrënjët e ideologjisë terroriste, si edhe hulumtimet për Islamin, kanë mundësuar që njerëzit të mësojnë se Islami është një fe paqësore që urdhëron tolerancën, drejtësinë, mëshirën dhe dashurinë. Islami papritur u bë temë kryesore e diskutimit në mbarë botën. Gjithnjë e më shumë burra shteti të njohur në botë, shkencëtarë politik, hulumtues dhe mendimtarë e marrin si të nevojshme ta kuptojnë Islamin në mënyrë të drejtë dhe kanë mbajtur fjalime që vënë në pah tolerancën Islamike dhe gatishmërinë për të arritur marrëveshje. Amerikanët ju kanë qasur organizatave Islamike për të gjetur informacionin më të saktë për Islamin dhe historinë Islamike. Si rezultat i këtij interesimi, Instituti për Hulumtimin e Mediave të Lindjes së Mesme raportoi se pas 9/11, 34,000 Amerikan u konvertuan në Islam. 40

E përjavshme e egiptiane *al-Ahram al-Arabi* botoi një letër të shkruar nga Dr. Ualid A. Fatihi i Fakultetit të Mjekësisë së Harvardit. Në të, ai pohoi se kur dëgjoji për herë të parë për sulmin, mendoi se puna që kishte bërë ai për ta bërë të njohur Islamit në Amerikë do të sprapset për 50 vjet. Mirëpo, shumë shpejtë e kuptoi se sa kishte gabuar. Ai vazhdon:

Të shtunën, më 15 Shtator, shkova me gruan dhe fëmijët e mi në kishën më të madhe në Boston, (Trinity Church – Kisha e Trinisë) në Sheshin Kopli, me ftesë zyrtare të Shoqërisë Islamike të Bostonit, për ta përfaqësuar Islamit me ftesë të posaçme të senatorëve të Bostonit. Të pranishëm ishin kryetari i Bostonit, gruaja e tij dhe krerët e universiteteve. Kishte më shumë se 1,000 njerëz atje ...

Lexova një deklaratë zyrtare të lëshuar nga klerikët udhëheqës Musliman që e dënonte incidentin (domethënë, sulmet). Deklarata sqaronte qëndrimin dhe parimet Islame dhe normat sublime të tij. Pastaj, lexova vargjet Kur'anore të përkthyer në anglisht ...

Njëri më tha: “Nuk e kuptoj gjuhën Arabe, por nuk ka dyshim se ato që i the janë fjalët e Allahut.”

Të dielën, më 16 Shtator, Shoqëria Islamike e Bostonit i bëri një ftesë të hapur Qendrës Islamike në Kembrixh, të lokalizuar në mes të Harvardit dhe MIT-it. Nuk prisnim më tepër se 100 njerëz, por për befasinë tonë erdhën më tepër se 1,000 njerëz, në mesin e tyre fqinjët, ligjëruesit e universitetit, pjesëtarë të klerit dhe madje edhe udhëheqësit e priftërinjëve të kishave përreth, të cilët na ftuan për të folur për Islamit. Të gjithë ata shprehën solidaritet me Muslimanët. Na u drejtuan shumë pyetje. Çdokush dëshironte të dijë për Islamit dhe të kuptoj normat e tij ...

Po atë ditë, prap u ftova për të marrë pjesë në një takim në kishë dhe prap pashë po të njëjtat gjëra. Të enjten, një delegacion prej 300 studentësh dhe ligjëruesish nga Harvardi vizituan qendrën e Shoqërisë Islamike të Bostonit, të shoqëruar nga Ambasadori Amerikan në Vjenë. Ata u ulën në dyshemenë e xhamisë, e cila ishte e mbushur plot. Ne ua shpjeguam atyre normat e Islamit dhe e mbrojtëm atë prej çfarëdo dyshimesh (të përhapura në media). Unë prap u lexova atyre prej vargjeve të Allahut dhe sytë (e tyre) u mbushën me lotë. Të pranishmit u prekën dhe shumë prej tyre kërkuan që të marrin pjesë në mësimet e përjavshme për jo-Muslimanët të mbajtura nga Qendra Islamike...

Të premtën, më 21 Shtator, Muslimanët morën pjesë në një takim të mbyllur me guvernatorin e Masaqusetit. Në takim, u mbajt një fjalim për futjen e Islamit në plan-programin shkollor, për ta informuar popullin (Amerikan) dhe për të luftuar racizmin kundër Muslimanëve që po lind nga mosdija e popullit Amerikan për këtë fe ...

Ekzistojnë vetëm disa shembuj për atë që ndodhi dhe po ndodhë në qytetin e Bostonit dhe në shumë qytete tjera amerikane, gjatë këtyre ditëve. Kthimi në fe në emër të Allahut nuk është minuar dhe nuk është kthyer prapa për 50 vjet siç kemi menduar në ditët e para pas 11 Shtatorit. Përkundrazi, 11 ditët që kanë kaluar janë sikur 11 vite në historinë e kthimit në fe në emër të Allahut. Sot po ju shkruaj me bindje absolute se gjatë disa viteve të ardhshme, Islami do të përhapet në Amerikë dhe në mbarë botën, me vullnetin e Allahut, shumë më shpejtë se që është përhapur në të kaluarën, sepse e tërë bota po pyet, “Çfarë është Islami!” 41

Në një emision të programit televiziv një javë pas 9/11, Ek rrëfeu se ç'kishte ndryshuar ajo ngjarje:

Dhe prap shumica prej nesh nuk e shohim atë në të vërtetë (ndryshimet pozitive). Mendoj se njëra prej dhuratave të vërteta, nëse mund ta quajmë ashtu, e javës së kaluar ka qenë njohja se ne jemi të ndryshëm për nga religjioni në aspektet që kurrë nuk i kishim marrë me mend... 42

Ky interesim i rritur për Islamin tërhoqi vëmendjen e shtypit amerikan dhe kjo çështje u bë temë e programeve të lajmeve në televizion. Një gazetë që u mor me këtë çështje ishte *The Los Angeles Times*. Një artikull i titulluar “Shprehjet e përkrahjes befasuese për Muslimanët” raportoi se një prej rezultateve më të papritura ishte se Amerikanët kishin filluar ta studiojnë dhe hulumtojnë Islamin dhe se ky interesim ishte aq i fuqishëm sa që befasoi madje edhe Muslimanët:

Shumë Amerikanë po hulumtojnë poashtu, disa për herë të parë, njërin prej besimeve më madhështore të botës dhe njërin prej qytetërimeve më të vjetra. Libraritë po shesin të gjitha kopjet e Kur’anit. Ligjëratat në universitet dhe shkëmbimet e mendimeve në mes të studentëve dhe profesorëve për Lindjen e Mesme dhe Islamin janë të mbushura përplot. Dijetarët e Lindjes së Mesme po ftohen në shfaqjet e lajmeve televizive vazhdimisht dhe po dallohen në rrugë sikurse njerëzit e famshëm. Dhe shumë njerëz të Lindjes – Musliman ose jo-Musliman – po përballen me një vërshim të përditshëm të pyetjeve për Islamin prej fqinjëve, bashkëpunëtorëve dhe të huajve... “Ne jemi të stërngarkuar,” tha Mahmud Abdel-Baset, drejtori fetar i Qendrës Islamike të Kalifornisë Jugore. Që nga sulmet, qendra me bazë në Los Anxhelos ka mirëpritur një sërë titullarësh, duke përfshirë Guvernatorin Grej Dejvis, Sherifin e Qarkut të Los Anxhelosit Li Baka dhe Kryetarin e Los Anxhelosit Xhejms K. Han... Riçard Hrair Dekmejian, një profesor i USC-së për politikën për Lindjen e Mesme, tha se kjo etje për njohjen e Islamit është rezultat i ndikimit të fuqishëm të sulmeve të 11 Shtatorit dhe mungesës së përgjithshme të diturisë fetare në Amerikë. 43

Sot në Amerikë, interesimi filloi me 9/11 dhe vazhdon të rritet dhe të bëhet më i përhapur. Në faqet në vazhdim, do ta shohim ngritjen e Islamit në Amerikë. Kur shikojmë gjithë këto zhvillime, duhet ta kemi parasysh një fakt themelor: Zoti ka dhënë lajmin e mirë të premtimit të Tij për besimtarët se feja e vërtetë do të vendoset në mesin e qenieve njerëzore. Ngjarjet që kemi përjetuar na tregojnë se, me vullnetin e Zotit, përmbushja e këtij premtimi është shumë afër. Për këtë arsye, jemi duke jetuar në një periudhë vendimtare dhe në një kohë të ndryshimit të thellë. Besimtarët duhet ta kuptojnë vlerën e kësaj periudhe, t’u ofrojnë informacionin më të mirë dhe më të saktë atyre të cilët ngadalë po i kthehen Islamit, t’u përgjigjen pyetjeve të tyre në mënyrën më të kënaqshme dhe të jenë përfaqësues të zellshëm të Islamit. Siç thot vargu më poshtë, kjo është një përgjegjësi e rëndësishme që Zoti u ka dhënë besimtarëve:

**Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit. (Kur’an, 16:125)**

## Muslimanët në Amerikë

Ka midis 6 dhe 7 milionë Muslimanë në Amerikë sot. Me fjalë të tjera, Muslimanët i kalojnë në numër disa fe të Krishtera dhe janë të barabartë me numrin e Çifutëve. Hulumtimi i bërë në vitin 2000 nga universitetet e mirënjohura Amerikane dhe fondacionet Islamike tregojnë se numri i Muslimanëve është duke u rritur me shpejtësi dhe se Islami po forcohet dita ditës gjithnjë e më shumë.

Tema kryesore e këtij hulumtimi, të njohur si *Projekti i Studimit të Xhamisë*, është themelimi i xhamive në Amerikë. Arsyeja për këtë është se xhamitë zënë një vend të posaçëm në çfarëdo

përpilimi statistikor të bërë në lidhje me komunitetin Musliman të Amerikës. Xhamitë në Amerikë janë si shtëpi adhurimi ashtu edhe vend takime për të biseduar me njëri tjetrin dhe për të nisur aktivitete kulturore për ta bërë Islamin të njohur më gjerë. Çdo xhami vendos marrëdhënie me shtypin për t'ia prezentuar Islamin një audience më të gjerë, flet me politikanët vendor, viziton shkollat dhe kishat, kyqet në dialog ndërfaqet dhe ndërmerr aktivitete tjera të tilla. Kështu, hulumtimi i bërë në këto xhami është njëri prej mjeteve më të dobishme për të mbledhur informacion të saktë dhe të qartë për gjendjen e këtij komuniteti.

Sipas këtij hulumtimi, Amerika tani ka rreth 1,209 xhami, shumica e të cilave u ndërtuan në kohë të fundit. Tridhjetë përqind e këtyre xhamive u ndërtuan në vitet e 1990-ta dhe 32% u ndërtuan në vitet e 1980-ta. Statistikat tjera tregojnë se në vitin 1994, numri i përgjithshëm i xhamive në Amerikë ishte 962; në vitin 2000, kishte rritje të këtij numri për 25%.

Këto të dhëna tregojnë një paralele të natyrshme me numrin në rritje të Muslimanëve. Për shembull, sipas vlerësimeve të bëra në vitin 1994, numri i Muslimanëve që marrin pjesë në shërbimet e xhamive ishte 500,000; në vitin 2000, kjo shifër ishte rritur në 2 milion – një rritje përafërsisht prej 300%. Një pjesë e rëndësishme e këtij numri përbëhet prej njerëzve të cilët u kthyen në Islam. I njëjti hulumtim tregon se rreth 30% e atyre besimtarëve janë persona të cilët u kthyen në fenë Islame. Sipas këtyre të dhënave, rreth 20,000 Amerikanë pranojnë Islamin çdo vit. 44

Shifrat e mësipërme janë rezultat i hulumtimit të bërë para 9/11 dhe mbështeten në të dhënat nga viti 2000. Në vitin 2001, posaçërisht pas 9/11, këto shifra janë rritur shumëfish.

Kjo rritje e shpejtë e Islamit në Amerikë është rrëfyer në një artikull lajmesh, “Islami po rritet në Amerikë,” në sajtin e internetit të ushtrisë Amerikane ([www.defenselink.mil](http://www.defenselink.mil))

Muslimanët, ata që besojnë në Islam, janë gjithandej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata mund të jenë mjeku juaj apo të ngasin taksinë tuaj. Ata mund t’ju shërbejnë në restorante apo t’ju këshillojnë në drejtësi. Dhe ata gjithnjë e më shumë mund të jenë në të njëjtin strofull, duke mbajtur të njëjtën pozitë apo duke punuar në të njëjtin aeroplan ku ju punoni ... Në Shtetet e Bashkuara, Islami është religjioni që rritet më së shpejti ... 45

Një artikull i *New York Times*, “Islami tërheq me mijëra të konvertuar,” përmban intervista me të konvertuarit, analizon rritjen e shpejtë të Islamit në Amerikë dhe konstaton:

Me diku rreth 6 milionë anëtarë në Shtetet e Bashkuara, Islami thuhet të jetë feja kombëtare që rritet më së shpejti, e nxitur nga imigrimi, shkalla e lartë e lindjes dhe konvertimi i përhapur. Një ekspert llogarit se 25,000 njerëz në vit bëhen Muslimanë në këtë vend; disa klerikë thonë se kanë parë të katërfishohet shkalla e konvertimit që nga 11 Shtatori. 46

Një segment i *ABC News*, “Islami: Batika në rritje në Amerikë,” njoftoi se disa sociologë parashohin se brenda 15 viteve do të ketë më shumë Muslimanë se Çifutë në Amerikë. 47

Ndikimi vazhdimisht në rritje i Islamit ka ofruar mundësi më të mira për Muslimanët që jetojnë në Amerikë. Një vend ku kjo rritje dhe zhvillim është më se i dukshëm është në Diërborn, në Miçigen. Një artikull në *Detroit News* për përhapjen e Islamit, në veçanti në Diërborn, përmendi numrin në rritje të xhamive të qytetit. Por, sipas këtij artikulli, kjo nuk është shenja e vetme e ndikimit në rritje të Islamit; efektet e kësaj rritjeje mund të vërehen në restorante, qendra tregtare dhe spitale. Për herë të parë në Miçigen, në një restorant të MeksDonalds-it, ka në dispozicion ushqime me mish të prerë sipas ligjit Islamik. Supermarketet e mirënjohura në Diërborn kanë filluar të shesin mish “hallall.” Zyrtarët e Spitalit Oukvud kanë filluar ta përshtatin shërbimin e ushqimit posaçërisht

për pacientët Muslimanë. Veç kësaj, gjatë gjithë muajit të Ramazanit, orët e shërbimit të mensës janë caktuar për t'iu përshtatur Muslimanëve. 48

Sikurse në Diërborn, Muslimanët në Çikago poashtu po bëhen me ndikim me shpejtësi. Këtu, komuniteti Islam dallohet për nivelin e tij të lartë të shkollimit dhe përparimit. Hulumtimi i bërë në vitet e 1990-ta tregoi se 16% e pjesëtarëve të komunitetit Musliman ishin doktor të mjekësisë, 33% ishin inxhenerë, 44% kishin tituj doktorësh, 84% ishin së paku të diplomuar në shkenca të ndryshme dhe vetëm 2% kishin më pak se shkollim të mesëm. Veç kësaj, kontributet e Muslimanëve në Çikago ishin të theksuara. Për shembull, arkitekti i Qendrës Xhon Henkok dhe Kullës Siërs (Sears Tower) ishte Musliman: Dr. Fazlur Rahman. Gadi se nuk ka spital pa një mjek Musliman në personelin e tij dhe gadi se nuk ka ndonjë prodhues i pajisjeve inxhenerike apo elektronike pa inxhenerë Muslimanë. 49

## Muslimanët në ushtrinë Amerikane

Prania e Muslimanëve në ushtrinë Amerikane po rritet dita ditës. Në fillim të viteve të 1990-ta kishte 2,500 Muslimanë në ushtri; tani ka midis 15,000 dhe 20,000 ushtarë. 50 Ekzistojnë dy arsye për këtë rritje të shpejtë: rritja e përgjithshme e popullatës Muslimane në Amerikë dhe se disa ushtarë të cilët shërbyen në vendet Muslimane u konvertuan. Rritja e tyre e vazhdueshme u ka mundësuar atyre t'i kryejnë obligimet e tyre fetare në qetësi. E para prej këtyre ishte emërimi nga ana e ushtrisë e një kapelani Musliman për t'ju shërbyer ushtarëve Muslimanë, një tregues i rëndësishëm se prania e Muslimanëve në ushtri është njohur zyrtarisht. Koloneli Herman Kajzer foli për këtë fakt në një fjalim në vitin 1994: "Ky fakt reflektoi numrin në rritje të Muslimanëve në shërbime gjatë dhjetë viteve të fundit. Ky fakt pasqyron rritjen në shoqërinë e Shteteve të Bashkuara ... ku Islami është feja që rritet më së shpejti në Shtetet të Bashkuara." 51

Si rezultat i kësaj, ushtria ka bërë disa lëshime për t'ua bërë më të lehtë jetën ushtarëve Muslimanë. Për shembull, mishi i dërrit nuk hyn në ushqimet e tyre, ata mund të kryejnë faljen e Xhumasë (të Premtes) në xhemat dhe ata të cilët dëshirojnë të shkojnë në haxh (pelegrinazh) e kanë më të lehtë ta përmbushin këtë obligim. Këto lëshime u raportuan në *Washington Post* në vitin 1998:

Gjatë Ramazanit, kur Muslimanët përmbahen nga ushqimi dhe pirja gjatë orëve të ditës, komandantët ushtarak nxiten t'ua lehtësojnë punën ushtarakëve dhe ushtarakeve të tyre që agjërojnë – duke i liruar ata, në disa raste, nga ushtrimet rigoroze fizike. Komandantët poashtu lejojnë orë pune fleksibile në mënyrë që Muslimanët të mund të hanë yftar, vaktin tradicional që shënon përfundimin e agjërimin dhe të marrin pjesë në tubimet shoqërore dhe faljet e komunitetit që pasojnë zakonisht. 52

Pra forcat ushtarake Amerikane janë me të vërtetë të interesuara për Muslimanët dhe përpiqen t'ua plotësojnë nevojat e tyre kur është e mundur. Njëra prej arsyeve kryesore për këtë është padyshim karakteri fetar i popullit Amerikan. Besimi i shumë Amerikanëve në Zot i ka shtyrë ata të marrin një qëndrim të respektueshëm dhe tolerant ndaj Muslimanëve, në veçanti pasi që ata kanë mësuar për vlerat Islamike. Njëri prej shembujve më të mirë për këtë mund të shihet në një fjalim të bërë nga ish Zëvendësi i Sekretarit të Mbrojtjes Xhon Hamre:

Mendoj se si Muslimanë dhe si të Krishterë, ne e kuptojmë se ç'është thotë jetosh në një botë të autoritetit – të autoritetit që na është shpallur nga Zoti. ... Ne jemi partnerë dhe jemi shokë dhe ne

kremlinjtë me vëllezërit dhe motrat tona Muslimane sonte në këtë festë dhe gjatë gjithë vitit. Në një Amerikë që nganjëherë është tepër e zënë me modën më të fundit të veshjes apo me modelin më të ri të veturës apo me gjëra tjera materiale, është mirë të jesh mes njerëzve të cilët mendojnë në mënyrë më të gjerë, të cilët mendojnë për marrëdhënien e tyre me Zotin, të cilët mendojnë për bamirësi (zekatë), dhënien e lëmoshës, si për njërin prej detyrave më qendrore të jetës. Kjo është një gjë madhështore. Ju jeni një popull madhështor me të cilin është kënaqësi të jesh. 53

## Islami në Mjetet Amerikane të Informimit

Sot, mjetet e informimit janë njëri prej faktorëve më me ndikim në formimin e opinionit publik, sepse ato ngjallin në njerëz ose simpati ose neveri ndaj një çështjeje të veçantë dhe i bën ata që ta pranojnë apo ta kundërshtojnë atë. Çështja për të cilin do të diskutojmë është mënyra se si kanë ndikuar mjetet e informimit në pikëpamjen e popullit Amerikan për Islamin.

Deri vonë, Islami në përgjithësi kishte një paraqitje të keqe në sektorë të caktuar të mjeteve Amerikane të informimit, të cilat u përpoqën t'i bindin njerëzit se Islami ishte një fe Arabe dhe se stereotipet negative të Arabëve ishin të vërteta në përgjithësi. Por ky informim i rrejshëm dhe pikëpamje paragjyquese kishte pikërisht efekt të kundërt: Në kundërshtim me largimin e pritur të opinionit publik prej Islamit, ai u bë religjioni që më së shpejti rritet në Amerikë. Këto raporte sollën Muslimanët dhe Islamin në jetërat e popullit Amerikan. Në këtë mënyrë, shumë njerëz që nuk dinin asgjë për Islamin u informuan dhe filluan të interesohen për të. Kjo poashtu është jetësim i vargut Kur'anor: **“Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është i dëmshëm për ju. All-llahu di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini.”** (Kur'an, 2:216)

Njoftimet e mjeteve të informimit që dukeshin negative në shikim të parë u bënë mjet me anën e të cilit u bënë raportime më të sakta që do ta parandalonin përhapjen e informimit të rrejshëm për Islamin dhe do ta paraqitnin Islamin në mënyrë më të mirë. Mjetet e informimit u përqendruan në Muslimanët për arsye të rritjes së shpejtë të popullsisë Muslimane. Kështu, gjatë viteve të 1990-ta Islami dhe Muslimanët u bënë njëra prej temave më të rëndësishme në mediumet Amerikane.

Gati të gjitha këto raporte nxjerrën në pah me saktësi mënyrën e të menduarit të Muslimanëve dhe atë që besojnë ata dhe i informuan jo-Muslimanët për Islamin. Ato shpjeguan jetën e përditshme dhe botëkuptimet e Muslimanëve dhe u dhanë rëndësi pikëpamjeve të të konvertuarve të vonshëm. Në të njëjtën kohë, këto raporte shpesh përmbanin pjesë të posaçme për historinë Islame, bazat e Islamit dhe Kur'anin. Faqet e internetit që u takojnë radio dhe TV stacioneve gjithashtu paraqitën adresat e sajtave Islamik në mënyrë që njerëzit të informoheshin më lehtë.

Ky proces i informimit u shpejtua si rezultat i interesimit të publikut pas 9/11. Gati të gjitha gazetat kryesore filluan të pyesin nëse ishte apo jo terrorizmi pjesë e pandarë e Islamit dhe të ofrojnë raporte të hollësishme që përmbanin pikëpamjet e akademikëve, klerit, historianëve dhe shkencëtarëve social. Si rezultat i kësaj, populli Amerikan përsëri kuptoi se Islami është një fe paqësore dhe mësoi se besimet e tyre fetare kishin shumë gjëra të përbashkëta me ato të Muslimanëve.

Kjo situatë padyshim se luajti një rol të rëndësishëm në rritjen e interesimit për Islamin. Gjatë kësaj kohe, shumë njerëz të cilët kryesisht nuk kishin dijeni për Islamin dhe nuk kishin kurrfarë qasjeje ndaj informimit të saktë tani mund të edukoheshin me një lehtësi relative.

## **Kur'ani është bërë Libri më i shitur në Amerikë**

Tragjedia e 9/11 bëri që rritja e Islamit në Amerikë të përshpejtohet shumë. Njëri prej treguesve më të qartë për këtë është fakti se pas sulmeve, Kur'ani u bë libri më i shitur në shumë shtete për një kohë të gjatë. Interesimi i Amerikanëve për Kur'anin u rrit në atë masë sa që Penguin Books, njëri prej botuesve më të njohur të Kur'anit në Anglisht, lajmëroi se kishte botuar 20,000 kopje shtesë pas 9/11. 54

*USA Today* raportoi për këtë interesim të madh në artikullin “Njerëzit duan të dijnë, prandaj Kur'ani është Bestseller,” duke thënë se shitja e Kur'anit ishte rritur për pesë herë. 55 Kur u pyet për mendimin e tij në lidhje me këtë çështje, një ekspert udhëheqës në Islam, Xhon Espozito, vuri në pah një gjë të rëndësishme:

Fuqia e Kur'anit është se një Musliman, apo kushdoqoftë, mund ta hap atë në cilëndo faqe dhe të marr një mesazh që ka të bëjë me kuptimin e jetës. 56

Përveç se u bë një bestseller, disa shkolla publike kërkuan prej nxënësve të tyre të mësojnë përmendësh disa vargje Kur'anore. Për shembull, nxënësit e klasës së shtatë në Bajron të Kalifornisë, sistemi i shkollës publike u desht të përcjellin një kurs tre-javor për t'u dhënë informacion të hollësishëm për parimet e Islamit. Në këtë kurs, ata u desht të mësonin përmendësh vargje Kur'anore, të mësojnë për historinë Islame dhe për jetën e Profetit Muhammed dhe madje të mbajnë fjalime në klasë duke përdorur emra Muslimanë që ata vet i kishin zgjedhur. Dhe ky program hyri në fuqi menjëherë. Bashkë me këtë, u propozua që nxënësit të mësojnë se si luten Muslimanët dhe cilat janë obligimet fetare të Islamit. 57

Njerëzit në shtetin Mejn treguan një interesim të madh për Islamin. Pak ditë pas 9/11, kishte një rritje të madhe të shitjes së Kur'anit dhe të librave për historinë Islame.

Më 22 Shtator, *Bangor Daily News (Lajmet Ditore të Bangorit)* raportoi për këtë interesim të njerëzve për Islamin në artikullin “Mainerët studiojnë Parimet e Islamit.” Ky artikull thoshte, pjesërisht:

Gjersa Amerikanët po përpiqen që të kuptojnë ngjarjet e javës së fundit, banorët e Mejnit si duket po u kthehen enciklopedive, librave të historisë, biografive, librave mësimor dhe vet Kur'anit për të kuptuar se çfarë besojnë shumica e Muslimanëve. Gig Uiks nga libraria Book Marc's në qendër të qytetit të Bangorit tha të mërkurën se libraria kishte shitur të gjitha kopjet e Kur'anit përveç njëres. ... Ajo tha se disa prej titujve janë porositur dhe presin gjersa botuesit të mund t'i rishtypin ato. Personeli i Borders Books, Music and Café në Bangor raportoi se kishin shitur pesë kopje të Kur'anit që nga 11 Shtatori, krahasuar me dy kopje që ishin shitur në mes të 1 Janarit dhe 10 Shtatorit. 58

Artikulli japte informacion të mëtejshëm për këtë interesim. Për shembull, nxënësit në Shkollën Teologjike të Bangorit, të cilët zakonisht studiojnë për Islamin kah fundi i vitit shkollor, deshën ta fillojnë kursin menjëherë dhe kështu Dejna Sojer, njëra prej mësueseve të shkollës, filloi një kurs për Kur'anin dhe jetën e Profetit. Në këtë kurs, Sojer tha se shpallja e të gjithë Muslimanëve

si terroristë ishte e njëjtë si të thuhej se të gjithë të Krishterët ishin përgjegjës për një krim të kryer nga një i Krishterë. 59 *The Guardian* paraqiti një artikull nga Xheremi Rifkin, ekonomisti i mirënjohur Amerikan, në të cilin ai shprehej se ndiehej i turpëruar që nuk kishte lexuar asgjë për Islamin para 9/11 dhe se tani nuk ishte i vetmi person i angazhuar për të mësuar për Islamin:

Më vjen turp të pranoj, por para 11 Shtatorit, nuk i kisha kushtuar vëmendje Islamit. Kisha dijani të përciptë për luftën historike në mes të Izraelit dhe fqinjëve të tij Arab. Dija pak për luftën me perëndimin për naftë. ... U desht të vdisnin 5,000 Amerikanë në një akt të tmerrshëm terrorist për ta tërhequr vëmendjen time. Sikurse shumë të tjerë, jam duke studiuar për Islamin – parimet e tij, luftërat e brendshme, ... vizionet. ..., ngjashmëritë e tij dhe dallimet e thella me Krishtërimin dhe Perëndimin... Nuk jam i vetëm. Shtatë prej 15 librave që prijnë në listën e librave të xhepit bestseller të *New York Times* i kushtohen Islamit. Kur'ani është bërë bestseller. E gjithë bota, duket, është kthyer në një klasë shkollore duke u përpjekur që ta kuptojmë arsyen e ngjarjeve tragjike të 11 Shtatorit dhe pasojave të tyre. 60

## **Ngritja e Islamit do të vazhdojë**

Të gjitha këto zhvillime tregojnë diçka mahnitëse: Islami është duke u përhapur me shpejtësi në Amerikë dhe gradualisht po fiton në fuqi. Kapitujt në vazhdim do të tregojnë se si kjo rritje nuk kufizohet me Amerikën, por se si Islami po përhapet çdokund në botë. Këto janë zhvillime shumë të rëndësishme dhe, me vullnetin e Zotit, janë shenja të shumë zhvillimeve më të rëndësishme. Prandaj, këto ngjarje janë lajm i mirë për besimtarët dhe arsye për gëzim dhe eksitim. Në Kur'an, Zoti shpall se feja e vërtetë me të vërtetë do të triumfojë, si në ajetin:

**Ai (All-llahu) është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzim të qartë e fé të vërtetë për ta bërë mbizotëruese mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë. (Kur'an, 61:9)**

Pra, ndërsa i vlerësojmë këto zhvillime nuk duhet të harrojmë se të gjitha këto janë premtime të Zotit. Një qëndrim i tillë është i rëndësishëm, poqese ato do të vlerësohen ashtu siç e meritojnë. Përndryshe, këto ngjarje do të konsiderohen si ngjarje të zakonshme në rrjedhën e përgjithshme të jetës dhe thjeshtë si rezultate të disa zhvillimeve politike. Mirëpo e vërteta është krejtësisht ndryshe. Në të vërtetë, Zoti ka përcaktuar çdo moment që ne përjetojmë në pajtim me Fatin që Ai ka përcaktuar për ne. Kur dhe si njerëzit i drejtohen Islamit, sa Kur'ana shet një shitore, si një zyrtar shtetëror fillon të interesohet për Islamin dhe kur, ku dhe si ky interesim do të vie në shprehje janë të gjitha zhvillime që Zoti tashmë i ka përcaktuar.

Edhe pse e dimë se Zoti krijon një arsye për çdo ngjarje, duhet ta mbajmë në mend gjithmonë se Ai tashmë ka përcaktuar fatin tonë. Duke marrë parasysh këtë vetëdije, ne kuptojmë se duhet ta falënderojmë Zotin për bekimin e krijimit tonë për të jetuar në këtë kohë, kur janë duke ndodhur zhvillime kaq të rëndësishme. Këtë e themi sepse çdo ngjarje që ne përjetojmë është një hap që shpie drejt zhvillimeve më madhështore dhe më të rëndësishme dhe çdo ngjarje e tillë lajmëron lajmin e mirë se koha e bekuar për të cilën Muslimanët kanë pritur me shekuj po afrohet. Falënderimi jonë për këtë mirësi duhet të marr si formën e fjalëve ashtu edhe të veprave. Me fjalë të tjera, ne duhet të punojmë për të shpejtuar përhapjen e mësimave morale të Kur'anit, të luftojmë kundër çfarëdo

ideologjie jofetare dhe ideve që pengojnë këtë zhvillim dhe të shfrytëzojmë çdo mundësi për t'i transmetuar këto mësimet.

Edhe një gjë tjetër duhet mbajtur mend gjithashtu: Bashk me këtë ngritje, Muslimanët do të mund të vazhdonin të përballen me presione të ndryshme prej qarqeve të caktuara. Megjithatë, shqetësime të tilla tejkalojnë shtrirjen e këtij libri. Sidoqoftë, ata s'mund t'na bëjnë ta shpërfillim faktin e rritjes së shpejtë të Islamit në mbarë botën, interesimin në rritje për Islamin dhe rritjen e vazhdueshme të popullatës Muslimane. Pra ne nuk duhet ta ngatërrojmë interesimin për Islamin, në veçanti në Perëndim, me qëndrimet dhe pozicionet armiqësore paragjyquese anti-Islame dhe anti-Muslimane që mund të vëzhgohen në disa qarqe. Këto dy tema duhet të diskutohen ndaras.

Ngjashëm, kur bota Perëndimore e studion Islamin, duhet të mendoj për vlerat morale të Kur'anit dhe për ata të cilët i kanë përvetësuar ato sinqerisht. Poqese nuk e bëjnë këtë, në vend të sjelljes së vendimeve dhe bërjes së politikave që do të kontribuonin për paqe në botë dhe të siguronin siguri dhe mirëqenie, dallimet do të mund të zmadhoheshin dhe dialogu do të dëmtohej. Bazamenti për një dialog midis dy qytetërimeve do të vendoset me vullnetin e mirë të besimtarëve, të cilët jetojnë me vetëdije në pajtim me parimet e larta morale që Zoti ka urdhëruar. Forcimi i një dialogu të tillë nënkupton se çdo pikëpamje dhe ideologji që agjitojnë dhunshëm kundër paqes dhe mirëqenies duke ndezur konfliktin, argumentin dhe luftën do të çrrënjohet. Mbështetja kryesore për luftën kundër terrorit, dhunës dhe çdo lëvizjeje që dëmton paqen botërore duhet të jenë bisedimet, dialogu dhe një diskutim në rrafshin e ideve. Kjo qasje është rruga më e mirë për të parandaluar hapat që ndërmerren për të sjellur shoqëritë botërore në paqe dhe siguri duke i dëmtuar në mënyrë të pavëmendshme njerëzit e pafajshëm dhe duke i përdorur për qëllime tjera.

# KAPITULLI 3

## EVROPA DHE ISLAMI

### Islami: Religjioni i Dytë më i madh i Evropës

Si në pjesë tjera të botës, Islami është në mesin e një rritjeje të shpejtë në Evropë. Ky zhvillim është duke tërhequr vëmendjen më shumë në vitet e fundit, siç dëshmohet nga shumë teza, raporte dhe artikuj të botuar për “vendin e Muslimanëve në Evropë” dhe “dialogun në mes të shoqërisë Evropiane dhe Muslimanëve.” Bashkë me këto raporte akademike, mediumet kanë sjellur raporte të shpeshta për Islamin dhe Muslimanët. Arsyeja e këtij interesimi qëndron në rritjen e vazhdueshme të shifrave të popullatës Muslimane në Evropë dhe faktit se kjo rritje nuk mund t’i përshkruhet vetëm imigrimit. Ndërsa imigrimi padyshim se ka pasur një ndikim të madh në rritjen e popullatës Muslimane, aq shumë studiues kanë adresuar këtë çështje për një arsye krejtësisht tjetër: shkallën e lartë të konvertimit.

Kisha Katolike e Romës, me bazë në Qytetin e Vatikanit, është njëri prej institucioneve që përcjell rrjedhat e konvertimit. Njëra prej temave kryesore gjatë takimit të Tetorit të vitit 1999 të sinodit Evropian, në të cilin mori pjesë gadi i gjithë kleri Katolik, ishte pozita e Kishës në mijëvjeçarin e ri. Tema kryesore e konferencës ishte rritja e shpejtë e Islamit në Evropë. *The National Catholic Reporter* raportoi se disa individ radikal pohuan se e vetmja mënyrë për të ndaluar Muslimanët të bëhen të fuqishëm në Evropë ishte që të ndalohej tolerimi i Muslimanëve dhe i Islamit; individë të tjerë më objektiv dhe më të arsyeshëm nënvizuan faktin se pasiqë dy religjionet besojnë në një Zot, nuk do të duhej të kishte vend për çfarëdo konflikti apo lufte në mes tyre. Në një seancë, Kryepeshkopi Karl Lehmann i Gjermanisë theksoi se ka më shumë pluralizëm të brendshëm në Islam se që shumë të Krishterë mund ta përfytyrojnë dhe se pohimet e radikalëve për Islamin nuk kishin mbështetje në të vërtetën. 61

Marrja në konsideratë e pozitës së Muslimanëve me sqarimin e pozitës së Kishës në mijëvjeçarin e ri ishte mjaft me vend, sepse një analizë e KB-ve e vitit 1999 tregonte se në mes të viteve 1989 dhe 1998, popullata Muslimane e Evropës u rrit më shumë se 100 përqind. 62

Sot, rreth 13 milion Muslimanë jetojnë në Evropën Perëndimore: 3.9 milion në Gjermani, 3.3 milion në Britani, 7.5 milion në Francë dhe të tjerët në vendet tjera. 63

Një hulumtim lidhur me këtë ka zbuluar se ndërsa numri i Muslimanëve në Evropë vazhdon të rritet, po ndodhë një thellim i vetëdijes fetare në mesin e Muslimanëve. Sipas një analize të bërë nga gazeta franceze *Le Monde* në Tetor të vitit 2001, krahasuar me të dhënat e grumbulluara në vitin 1994, shumë Muslimanë vazhdojnë të kryejnë faljet e tyre, të shkojnë në xhami dhe të agjërojnë. Kjo vetëdije është vënë re shumë më tepër në mesin e studentëve të universitetit. 64

Në një artikull të revistës *Aktuel*, i cili u bazua në raportet në shtypin e huaj, hulumtuesit Perëndimor thonë se Evropa do të bëhet njëra prej qendrave më të rëndësishme për përhapjen e Islamit rreth 50 vite më vonë. 65

Bashkë me këtë hulumtim sociologjik dhe demografik, ne poashtu nuk duhet të harrojmë se Evropa nuk është njohur me Islamin vetëm në kohët e fundit, por se Islami është në të vërtetë një pjesë e pandashme e Evropës.

## Historia e Islamit në Evropë

Evropa dhe mbretëria e Islamit kanë pasur marrëdhënie të ngushta me njëra tjetrën me shekuj të tërë. Së pari, shteti i Andaluzisë (756-1492) në Gadishullin Iberik dhe më vonë Kryqëzatat (1095-1291) dhe pushtimi Otoman i Ballkanit (1389), shkaktuan një raport reciprok të qëndrueshëm në mes të dy shoqërive. Shumë historianë dhe sociologë sot pohojnë se Islami ishte arsyeja kryesore e lëvizjes së Evropës nga errësira e Mesjetës drejt shkëlqimit të Renesansës (Rilindjes) së saj. Në një kohë kur Evropa ishte e prapambetur në mjekësi, astronomi, matematikë dhe shumë fusha tjera, Muslimanët posedonin një thesar të pafund të dijes dhe mundësi të mëdha zhvillimi.

Ngjarja e parë që i bëri Evropianët të vetëdijshëm për vendin e ardhshëm të rëndësishëm të Islamit në jetërat e tyre ishte pushtimi i Jerusalemit nga ana e kalifit 'Umar ibn al-Khattab (638). Kjo bëri që Evropa të kuptojë për herë të parë se Islami po zgjerohej dhe po i afrohej vet kufijve të saj. Arsyeja kryesore për Kryqëzatat, të nisura katër shekuj më vonë, ishte ta rikthenin Jerusalemin prej Muslimanëve. Por pjesëmarrësit e Kryqëzatave që këtë e kishin për qëllim fituan diçka tjetër, sepse kontakti që ata krijuan me botën Muslimane ishte hapi i parë drejt rilindjes së Evropës. E dominuar nga errësira, konflikti, lufta dhe despotizmi, Evropa u ndesh me qytetërimin e përparuar të botës Islamike dhe pa se banorët e saj ishin shumë të përparuar dhe të qytetëruar, si edhe mjaft të avancuar në fushat e mjekësisë, astronomisë dhe matematikës si edhe në jetën e tyre shoqërore. Ata poashtu panë se vlerat rralë herë të gjetura në Evropë në atë kohë (p.sh. pluralizmi, toleranca, mirëkuptimi, dhembshuria dhe vet-flijimi) ishin aspekte të parimeve të larta morale të shprehura prej Muslimanëve, të cilët ishin të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre fetare.

Në ndërkohë, me vazhdimin e Kryqëzatave, shoqëritë Evropiane gjithashtu kishin marrëdhënie me një shoqëri Muslimane shumë më të afërt me shtëpinë e tyre: mbretërinë Muslimane të Andaluzisë që ndodhej në pjesën jugore të vet kontinentit të tyre. Andaluzia kishte një ndikim të madh kulturor në Evropë deri në abdikimin e saj në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë. Shumë historianë të cilët kanë studiuar ndikimin e Andaluzisë në Evropë pajtohen se kjo mbretëri, me strukturën e saj shoqërore dhe nivelin e lartë të qytetërimit, ishte shumë më e përparuar se pjesa tjetër e Evropës dhe se ishte njëri prej faktorëve kryesor në zhvillimin e qytetërimit Evropian. Historiani i mirënjohur spanjoll Blanko Ibanez shkruan se:

Disfata në Spanjë nuk erdh nga veriu; pushtuesit Muslimanë erdhën nga jugu. Kjo ishte shumë më tepër se një fitore, ishte një kërcim i qytetërimit. Për shkak të kësaj, lindi qytetërimi më i pasur dhe më madhështor i njohur në Evropë dhe lulëzoi gjatë Mesjetës në mes të shekujve 8 dhe 15. Gjatë kësaj periudhe popujt verior ishin të dërmuar nga luftërat fetare dhe ndërsa ata vërtiteshin në hordhi të etura për gjak, popullsia e Andaluzisë tejkaloi numrin prej 30 milionëve. Në këtë numër, i cili ishte i lartë për atë kohë, pjesëtarë të çdo race dhe feje lëviznin lirisht dhe ishin të barabart dhe puls i shoqërisë ishte shumë energjik. 66

Me rrugët e saj të ndriçuara mirë, kryeqyteti Kordoba ofronte një kontrast mahnitës për qytetet Evropiane dhe sipas historianit anglez Xhon W. Draper, "Shtatëqind vjet pas kësaj kohe, nuk kishte më shumë se një llampë publike në Londër. Në Paris, shekuj më vonë, kushdo që kalonte pragun e derës së vet në një ditë me shi futej në baltë deri në nyjet e këmbëve." 67

Andaluzia përfundimisht pushoi së ekzistuari në vitin 1492 me rënien e Granadës, mbretërisë së fundit Muslimane në Gadishullin Iberik. Por tani, Evropianët u përballën me Perandorinë

Otomane, e cila po fillonte të përparonte në Ballkan gjatë shekullit të pesëmbëdhjetë si rezultat i disa fitoreve dhe konvertimit në masë në mesin e popujve të Ballkanit. Ky konvertim kurrë nuk u bë me dhunë apo nuk u arrit me trysni. Me kohë, parimet morale Islamike të vendosura nga Otomanët ndikuan që ata që ishin dëshmitarë të tyre të zgjedhin Islamin me vullnet të lirë. Qytetërimi Otoman, i ndërtuar në vlerat morale të Kur'anit për drejtësi, barazi, tolerancë dhe dhembshuri, qëndroi në Ballkan për 400 vjet dhe gjurmët e tij ende mund të vërehen atje. (Një numër i madh i këtyre gërmadhave u shkatërruan nga trupat dhe predhat Serbe gjatë luftës në Bosnje, por kjo nuk ndryshon faktet e historisë.) Ky qytetërim i bazuar në Kur'an e bëri Islamin pjesë të rëndësishme të Evropës. Madje edhe sot, një numër i madh i Muslimanëve Evropian jetojnë në Ballkan.

Një person i cili beson se qytetërimi Evropian ka mësuar shumë prej Islamit dhe se dy qytetërimet kanë qenë gjithmonë ngusht të lidhura është Çarllsi, Princi i Uellsit. Princi Çarlls përshkruan qytetërimin Islam dhe atë që Andaluzia dhe përvoja Otomane në Ballkan e kanë mësuar Evropën:

Diplomacia, tregtia e lirë, kufijtë e hapur, teknikat e hulumtimit akademik, të antropologjisë, etikës profesionale, modës, mjekësisë alternative, spitaleve, të gjitha erdhën prej këtij qyteti madhështor të qyteteve. Islami mesjetar ishte një fe e tolerancës së shquar për kohën e tij, që lejonte Çifutët dhe të Krishterët të praktikojnë besimet e tyre të trashëguara dhe që vendosi një shembull i cili fatkeqësisht nuk u kopjua për shumë shekuj në Perëndim. Befasia, zonja dhe zotërinjë, është shkalla në të cilën Islami ka qenë pjesë e Evropës për aq kohë të gjatë, së pari në Spanjë, pastaj në Ballkan dhe shkalla në të cilën ai ka kontribuar aq shumë ndaj qytetërimin për të cilin ne të gjithë shumë shpesh mendojmë, gabimisht, si qytetërim tërësisht Perëndimor. Islami është pjesë e së kaluarës dhe të tashmës sonë, në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore. Ai ka ndihmuar të krijohet Evropa moderne. Është pjesë e vet trashëgimisë sonë, nuk është një gjë e ndarë. 68

Ambasadori Suedez Ingmar Karlson, i njohur në Turqi për librin e tij *Islami dhe Evropa*, thotë se në kohën e Andaluzisë, të Krishterët, Muslimanët dhe Çifutët jetuan së bashku në paqe dhe se kjo do të duhej të merrej si model në Evropë.

Përfaqësuesi i lartë i Bashkësisë Ndërkombëtare në Bosnjë dhe Hercegovinë, Wolfgang Petriq, thekson në një artikull të botimit të 20 Nëntorit 2001 të *The New York Times* se lufta kundër terrorit nuk duhet të drejtohet kundër Islamit dhe se kurrë nuk duhet harruar se Islami është në të vërtetë pjesë e Evropës. Në artikullin e tij "Islami është gjithashtu Pjesë e Perëndimit," ai deklaroi: "Kur e tejkalojmë paradigmen mes nesh dhe tyre, do të mund të përkujtonim se Islami është pjesë e traditës Evropiane." 69 Përkujtimi i këtij fakti historik është një mënyrë për të parandaluar kaosin e dëshiruar nga ata nxitës të cilët parashirojnë tezën e "konfliktit të qytetërimeve." Dallimet në qytetërimet nuk janë arsye për konflikt; në të vërtetë, ato mund të jenë mjet i rëndësishëm për përparimin e dialogut.

## Udhëheqësit Evropian dhe Islami

Udhëheqësit Evropian kanë marrë parasysh dy fakte me shumë kujdes: Nuk do të ketë konflikt në mes të Islamit dhe Krishtërit dhe Islami nuk është bërë aleat me terrorizmin. Shumica e udhëheqësve qeveritar Evropian dhe e politikanëve të mirënjohur kanë dërguar mesazhe që e lavdërojnë Islamin dhe që shprehin interesim për mësimet e tij morale.

Siç u përmend më lartë, Princ Çarlisi ka një lidhje të ngusht me Islamin. Ai e shprehi këtë së pari në Oksford në vitin 1993. Që nga ajo kohë, ai ka pasur lidhje të afërta me Muslimanët që jetojnë në Angli dhe ka marrë pjesë në shumë takime dhe ceremoni përrurimi të organizuara nga Muslimanët. Ai poashtu ka shprehur admirimin e tij për Islamin shumë herë. Në Uilson Park në vitin 1996, ai e bëri të qartë admirimin e tij për Islamin, si edhe arsyet për këtë. Duke i theksuar çështjet në vazhdim, ai deklaroi:

Ndiej se neve në Perëndim do të mund të na ndihmonte për t'i rizbuluar rrënjët e të kuptuarit tonë një vlerësim i respektit të thellë të traditës Islamike për traditat e pafund të rregullit natyror. ... Materializmi modern është i çekuilibruar dhe gjithnjë e më i dëmshëm sa i përket pasojave të tij afatgjata. ... Por gjatë tre shekujve të fundit, së paku në botën Perëndimore, një ndarje e rrezikshme ka ndodhur në lidhje me mënyrën se si ne e përfytyrojmë botën rreth nesh. Shkenca është përpjekur të marrë monopolin, madje edhe të bëjë tirani, mbi të kuptuarit tonë. Feja dhe shkenca janë ndarë... Ne tani sa po fillojmë të vlerësojmë pasojat shkatërrimtare... Shkenca na ka bërë një shërbim të pallogaritshëm në paraqitjen e neve të një bote shumë më komplekse se që e kemi përfytyruar ndonjëherë. Por në formën e saj materialiste, një-dimensionale, ajo nuk mund të shpjegojë gjithçka. ...\_Kjo pikëpamje (materialiste) është krejtësisht e kundërt, për shembull, me botëkuptimin e zejtarit apo artistit Musliman, i cili nuk brengoset kurrë me pamjen për hir të saj, as me përparimin në zotësinë e tij, por është i kënaqur me nënshtrimin e aftësisë së njeriut Zotit. Ajo pikëpamje besoj se pasqyron fragmentin e paharrueshëm në Kur'an: "Ngado që të kthehesh aty është fytyra e Zotit dhe Zoti është Gjithëpërfshirës, i Gjithëdijshëm". ... Ekzistojnë shumë mënyra me të cilat mund të ndërtohen mirëkuptimi dhe vlerësimi reciprok. Ndoshta do të mund të fillonim, për shembull, duke pasur më shumë mësues Muslimanë në shkollat Britanike ose duke inkurajuar shkëmbimin e mësuesve. Gjithkund në botë njerëzit dëshirojnë të mësojnë Anglisht. Por në Perëndim, ne kemi nevojë të mësohemi nga mësuesit Islamik se si të mësojmë me zemrat tona, si edhe me kokat tona.

70

Përmes Fondacionit të Princit, Princi Çarlisi është përpjekur t'u sjellë dobi Muslimanëve. Qendra e Hulumentit Islamik e Oksfordit, e cila filloi aktivitetet e saj në vitin 1993, u themelua me sponsorimin e tij. Dega e Arteve Tradicionale dhe Pamore Islamike, e cila drejton aktivitetet e saj në lidhje me fondacionin e tij, punon të ofroj, mes gjërave tjera, mjetet sociologjike dhe ekonomike për të mbështetur traditat dhe kulturat e Muslimanëve Britanik, të mbulojë shpenzimet e shkollimit për fëmijët Muslimanë dhe të vendos dialog ndërfaqësor. Së voni, përmes këtij seksioni, Princi grumbulloi 10 milionë funta për Projektin e Qendrës Muslimane që do të themelohet në Londër. 71

Princi Çarlisi tani në veçanti merret me edukimin e rinisë Muslimane. Në vitin 2001, për herë të parë ai ftoi Muslimanët të marrin pjesë në kremtimin e Ramazanit në Pallatin e Bakingemit, dhe atje u shprehi mendimet e tij për këtë çështje të rinjëve Muslimanë të ftuar posaçërisht. Ngjarja u lajmërua në *Muslim News (Lajmet Muslimane)* me fjalët në vazhdim:

Ai mirëpriti "ndjeshmërinë dhe imagjinatën më të madhe" të ofruar nga rinia Muslimane, sepse pa të "do të bëhemi shumë më të zhveshur dhe shterpë." Princi Çarlisi lavdëroi larminë e rinisë së pranishme Muslimane: "Ju përbëni atë që unë mund ta përshkruaj vetëm si një tapiceri të pasur që përbën një ndryshim të pamasë për larminë dhe pasurisë e vendit tonë. Njëra prej gjërave që unë jam munduar gjithmonë ta bart tek të tjerët, që nuk është gjithmonë një gjë e lehtë, është se në një botë e cila është gjithnjë e më shumë jofetare, gjithnjë e më shumë materialiste, është absolutisht e

domosdoshme për gjithë ata që besojnë dhe kanë besim në diçka më madhështore se ne në diçka përtej materiales, të përkujtohen dhe kremtohen.” 72

Gjatë kësaj pritjeje, ai bisedoi me individët e rinjë Muslimanë për nevojat e tyre për më shumë se një orë, duke i pyetur ata nëse ishin ndeshur me çfarëdo vështirësish në shkollimin e tyre, karrierat dhe praktikimin e Islamit. Mes gjërave tjera, princi ishte në veçanti kureshtar të dijë nëse të rinjët kuptonin frymën e Kur’anit, nëse e kishin lexuar atë prej fillimit e deri në mbarim, nëse ishin ballafaquar me çfarëdo vështirësi në shkollë gjatë Ramazanit dhe nëse ishin të kënaqur me ushqimin e ofruar në shkollat e tyre për yftar. 73

Interesimi i treguar nga ana e Princit Çarlls është padyshim tejet i rëndësishëm. Ndryshimi në të menduar i burrave të mirënjohur të shtetit për këtë çështje është një hap shumë i madh drejt çrrënjësjes së opinionit të gabuar që disa qarqe në Perëndim janë përpjekur të krijojnë për Islamin. Është e qartë se një shoqëri udhëheqësit e së cilës kuptojnë bukurinë dhe superioritetin e parimeve morale Islamike do të jetë në gjendje t’i afrohet Islamit shumë më me lehtësi dhe Muslimanët që jetojnë në atë shoqëri do të kenë jetë më të qetë. Për këtë arsye, është një përgjegjësi e rëndësishme të sigurohemi se njerëz të shquar do të pranojnë informacion të saktë për Islamin. Njerëzit që janë të njoftuar me Islamin dhe mësimet e tij morale, pa marrë parasysh pozitën e tyre, padyshim se do t’i ndajnë mbresat e tyre me të tjerët. Nëse ata janë nga mesi i udhëheqësve të asaj shoqërie të caktuar, si ata që drejtojnë shoqërinë ashtu edhe ata që u drejtohen masave do të kenë dobi prej këtyre mbresave.

Prandaj, kur t’i lexoni këto përshkrime, kuptoni natyrën e mrekullueshme të këtyre zhvillimeve. Në botën e sotme Perëndimore, ka një afrim në rritje me Islamin. Padyshim se ky është lajm i mirë për Muslimanët të cilët punojnë për të treguar dëshmitë e Ekzistencës dhe Njësisë së Zotit, për të mposhtur ideologjitë ekzistuese materialiste dhe për t’ua përcjellur/komunikuar fenë e vërtetë të tjerëve. Besimtarët janë poashtu përgjegjës për t’ua përcjellur këtë lajm të mirë të gjithë Muslimanëve.

## **Ata që kthehen në Islam**

Siç u theksua më lartë, simpatia që udhëheqësit ndiejnë për Islamin prek thellë dëshirën e njerëzve për t’iu afruar Islamit. Një tregues i kësaj është numri i Evropianëve të cilët, gjatë disa viteve të fundit, janë konvertuar në Islam. Hulumtimi tregon se këta të konvertuar të rinjë nuk janë të paedukuar; për më tepër, shumica e tyre kanë një shkollim dhe karrierë universitare.

Numri i 30 Prillit 2001 i gazetës *The Daily Telegraph* publikoi informacionin për kthimin në Islam, posaçërisht në Angli. Duke i intervistuar të konvertuarit, tabloja në vazhdim doli në sipërfaqe: Shumica prej tyre kanë pozitë në shoqëri, kanë lidhje të forta familjare dhe e zgjedhën Islamin pas një hulumtimi dhe studimi të konsiderueshëm. Për shembull, Xho Ahmed-Dobson, djali i ish Ministrit të Shëndetësisë, ishte 16 vjeçar kur një shok ia dha një kopje të Kur’anit si dhuratë. Në të, thot ai, ai gjeti përgjigjet në të gjitha pyetjet e tij. Ai zyrtarisht pranoi Islamin në moshën 23 vjeçare dhe u përkrah nga familja e tij për këtë vendim. Me sa duket, babai i tij i jap atij libra Islamik si dhurata të Kërshëndellave çdo vit. Në mesin e të konvertuarve të vonshëm në Angli janë njerëz si djali i Xhon Birtit, ish drejtorit të përgjithshëm të BBC-së dhe vajza e Lordit Xhastis Skot, një gjykatës i shquar. Gjatë 20 viteve të fundit, rreth 20,000 njerëz në Angli janë konvertuar dhe, si në

shumë vende tjera, lëvizja drejt Islamit është shpejtuar. Sipas Xhamisë së Mançesterit, pas ngjarjeve të 9/11, gjashtëmbëdhjetë individë pranuan Islamin vetëm atje. Njëra prej gjërave interesante që doli në shesh nga studimi i tillë për të konvertuarit është se shumë më tepër femra po kthehen në Islam. Në Amerikë, një në katër të konvertuar është femër; në Angli, është numri një në dy. 74

Islami poashtu po rritet me shpejtësi në Danimarkë. Pas fesë zyrtare Protestante vjen Islami dhe numri i Katolikëve është pakëz më i vogël se numri i Muslimanëve. Prej 5.5 milion Danezëve, 3% janë Muslimanë. 75 Kjo rritje në numrin e Muslimanëve është pasojë e imigrimit të lartë. Kjo rritje u diskutua në shtypin Danez në një raport të titulluar “Ardhmëria e Danimarkës: Çdo i dyti person është Musliman.” Studimi i bërë nga sociologu i mirënjohur Eyvind Veselbo, i cili jeton në Danimarkë, tregon se numri i Muslimanëve në Danimarkë do të rritet në masë të konsiderueshme në të ardhmën e afërt. 76

## Raportet për Islamin në Medime

Është interesant fakti se numri i raporteve objektive në medimet Perëndimore që paraqesin Islamin është rritur. Posaçërisht pas sulmeve të 9/11, njerëzit ishin kureshtarë për Islamin dhe po kërkonin informacion të saktë. Si reagim, medimet bënë raporte dhe programe të ndryshme. BBC-ja transmetoi filma dokumentar për Islamin në shumë kanale televizive, ftoi mysafirë të posaçëm për t’u paraqitur në emisione të drejtpërdrejta debatesh dhe përgatiti një seri programore që prezentonte Islamin. Veç kësaj, shumë stacione televizive shtuan pjesë të posaçme për Islamin në faqet e tyre të internetit për të ofruar informacion për kushtet themelore të Islamit, historinë, thëniet e Profetit dhe vargjet Kur’anore. U dhanë edhe ueb sajtat që ofrojnë informacion më gjithëpërfshirës.

Veç kësaj, shumë revista dhe gazeta përmbajnë artikuj për Islamin për t’iu përgjigjur pyetjeve të njerëzve. Për shembull, botimi i 1 Tetorit 2001 i revistës *Time* solli një artikull nga Karen Armstrong të titulluar “Fytyra e vërtetë, paqësore e Islamit,” që jap informacionin në vazhdim:

Pikërisht fjala *Islam*, e cila nënkupton “nënshtrimin,” është e lidhur me fjalën Arabe *salam*, apo paqë. Kur Profeti Muhammed solli shkrimin e frymëzuar të shenjtë të njohur si Kur’an tek Arabët në fillim të shekullit të shtatë të erës së re, pjesa kryesore e misionit të tij i kushtohej pikërisht dhënies fund të atij lloji të kasaphanës të cilën e përjetuam në Nju Jork dhe Uashington. ... Prandaj, në Kur’an, e vetmja luftë e lejueshme është ajo e vet-mbrojtjes. Muslimanët nuk mund t’i fillojnë armiqësitë (2:190). Lufta është gjithmonë e ligë, por ndonjëherë të duhet të luftosh për t’iu shmangur ... persekutimit. ... Kur’ani citon Tevratin, shkrimin e shenjtë të Çifutëve, i cili u lejon njerëzve që të hakmerren sy për sy, dhëmb për dhëmb, por sikurse Ungjilli, Kur’ani këshillon se është e merituar të heqësh dorë nga hakmarrja në frymë të bamirësisë (5:45). ... Islami nuk është i dhënë pas luftës ... Kuptimi parësor i fjalës xhihad nuk është “lufta e shenjtë” por “përpjekja”. ... Në një formulim në të cilin Arabishtja është tejet e theksuar, Kur’ani këmbëngul, “Nuk duhet të ketë dhunë në çështjet e besimit!” (2:256). Në mënyrë të vazhdueshme Muslimanët janë të urdhëruar t’i respektojnë Çifutët dhe të Krishterët, “Ithtarët e Librit,” të cilët e adhurojnë të njëtin Zot (29:46).

Në fjalët e cituara nga Muhammedi (as) në njërën prej hutbeve (predikimeve) të fundit publike, Zoti u thot të gjitha qenieve njerëzore, “O ju njerëz, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vetë” (49:13) – jo për të pushtuar, konvertuar, nënshtruar, fyer apo masakruar, por për t’ua zgjatur dorën të tjerëve me zgjuarsi dhe mirëkuptim. 77



# KAPITULLI 4

## ISLAMI PO RRITET NË RUSI DHE KINË, POASHTU

### Muslimanët në Rusi

Zhdukja e sistemit komunist në fillim të viteve të 1990-ta e futi Rusinë në një periudhë të re. Sistemi komunist, i bazuar në filozofinë materialiste, vendosi një rend shoqëror të bazuar në pikëpamjen se qeniet njerëzore nuk ishin asgjë më shumë se materie dhe pohimet se ndërgjegja njerëzore është produkt i materies në lëvizje. Sipas këtij pohimi, inteligjenca njerëzore, mendimi, ndjenjat, gjykimet, prirjet dhe vullneti janë rezultat i reaksioneve kimike brenda trupit, i cili është një lloj makine. Prandaj Marksizmi, i cili është një interpretim i materializmit, i konsideron gjithë kulturën njerëzore, qytetërimin, fenë, konceptet e qeverisjes, ligjin, familjen dhe parimet morale si të varura nga faktorët material. Sipas Marksit, të gjitha këto gjëra rrjedhin prej dallimeve në mënyrën e prodhimit të tyre dhe ndryshojnë me kalimin e kohës.

Me hedhjen poshtë të vlerave fetare dhe me përkrahjen e mënyrës së tillë të menduarit, materializmi është në lajthitje të rëndë. Njerëzit nuk janë vetëm krijesa materiale, sepse secili prej tyre ka shpirt që nuk është, siç pohojnë materialistët, produkt i materies. Përkundrazi, ajo që ne quajmë “krijesa materiale” janë gjërat që shihen, dëgjohen dhe ndihen prej shpirtit. Është e pamundshme të definohen funksionet e shpirtit njerëzor në aspektin e kushteve materiale. Zoti e krijoji atë dhe frymëzoi cilësi të posaçme në të dhe çdo individ jeton jetën e tij apo të saj në pajtim me këto cilësi të posaçme. Në Kur'an, Zoti urdhëron:

**Ai që përsosi krijimin e çdo sendi, e krijimin e njeriut e filloi nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët. Mandej, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) dhe nga ana e vet i jap shpirt atij dhe Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të parit dhe me zemër. Sa pak falënderim që tregoni. (32:7-9)**

Nën qeverisjen e saj komuniste, Rusia përvetësoi këtë paragjykim materialist dhe e bëri atë bazën e jetës së saj shoqërore dhe të rendit shoqëror. Regjimi komunist, i cili i konsideronte qeniet njerëzore si mjete të prodhimit dhe besonte se Social Darwinizmi do të mund të zbatohet në raportet njerëzore, la shkatërrim të jashtëzakonshëm pas vetes, sepse Social Darwinizmi doli prej teorisë joshkencore të evolucionit të Çarlls Darvinit, e cila sugjeron se qeniet njerëzore janë kafshë të zhvilluara raportet e të cilave do të mund të udhëhiqeshin nga ligjet e njëjta që udhëheqin kafshët. Në këtë rend, prej të cilit u larguan besimi në Zotin dhe parimet morale fetare, nevoja të tilla themelore njerëzore si dashuria, respekti, dhembshuria, mëshira, vetflijimi, përkushtimi dhe besnikëria nuk kishin vend. Kështu u zhvillua një psikologji e masës. Njerëzit jetonin në ankth dhe frikë të vazhdueshme. Ata humbën cilësitë njerëzore të dashurisë, dhembshurisë dhe mëshirës dhe kryen çdo lloj krimi për shkak të besimit se nuk do të ndëshkoheshin.

Por Zoti ktheu këtë shoqëri drejt religjionit të vërtetë. Shkatërrimi shpirtëror i Rusisë dhe degjenerimi moral më vonë u shëndrruan në mjet me anën e të cilit qeniet njerëzore, si shoqëri, do t'i

afroreshin religjionit dhe natyrës shpirtërore. Vite më parë, dijetari Islamik Bediuzzaman Said Nursi shpalli lajmin e mirë për Muslimanët se ata do të bëheshin të fuqishëm në Rusi dhe se populli Rus do t'i kthehej Islamit. Pak kohë pas revolucionit Rus të vitit 1917, Said Nursi i cili u zu rob nga ushtarët Rus, tha se komunizmi do të rrënohej një ditë dhe se Islami do të përhapej në gjithë Rusinë. Në një bisedë me një ushtar Rus, ai tha: “Tri drita do të shfaqen njëra pas tjetrës në botën Islamike të Azisë. Tri hije nga ana juaj do të shfaqen njëra mbi tjetrën. Perdja despotike do të çirret dhe rrudhet dhe unë do të vi dhe do ta ndërtoj shkollën time këtu.” Me këto fjalë ai tregoi përparësitë që Muslimanët do të kishin në Rusi. Në një vend tjetër, ai tha:

Si pasojë e dy luftërave të tmerrshme botërore, me zgjimin e gjithëmbarshtëm të njerëzve, një komb pa fe nuk mund të mbijetojë. Rusia nuk mund të jetojë pa fe. Ata poashtu nuk mund të kthehen prapa në Krishtërim. Ata mund të jenë të varur më së shumti nga Kur’ani që thyen mosbesimin dhe që bazohet në të drejtën dhe të vërtetën dhe që bind zemrën.

Siç tha Said Nursi, populli Rus ka kuptuar se nuk mund të ketë komb pa fe dhe kjo mënyrë e të kuptuarit i ka udhëzuar ata drejt fesë së vërtetë të Islamit. Sot, 20 milion Muslimanë jetojnë në Rusi – përafërsisht 15% e popullatës. Shumica e tyre nuk janë imigrant apo banorë të huaj, por njerëz që kanë jetuar atje për më shumë se 1,000 vjet. Nën komunizëm, xhamitë u mbyllën dhe u shëndrruan në magazina, zyrtarët fetar u arrestuan dhe u mërguan me forcë dhe u ushtrua presion i madh mbi Muslimanët për ta braktisur fenë e tyre. Tani ekziston një masë e madhe e njerëzve që i afrohen Islamit, një masë që nuk mund të shpërfillet. Themelimi i Universitetit Islamik Rus në vitin 1998, universitetit të parë Islamik në vend dhe rritja e numrit të xhamive në Tataristan prej 18 gjatë periudhës sovjetike në më shumë se 1,000 sot, janë shembuj të ngritjes së Islamit në Rusi. 78

Këta janë vetëm dy shembuj dhe nuk ka dyshim se ato janë zhvillime shumë të mira dhe shumë të rëndësishme. Në Rusi, në vendlindjen e komunizmit, zëri i Islamit po dëgjohej dhe me vullnetin e Zotit, kjo rritje do të shpejtohet edhe më shumë.

## **Islami në Kinë**

Deri më tani, kemi bërë fjalë për rritjen e lëvizjes drejt Islamit pas rrëzimit të komunizmit. Situata qëndron pak më ndryshe në Kinë, njërin prej bastioneve të fundit të komunizmit. Këtu, Islami është në rritje, por pasiqë ideologjia e Kuqe e Maos është ende në fuqi, kundërshtimi ndaj religjionit po vazhdon me të njëjtin ritëm. Figurat fetare ende po arrestohen dhe torturohen, vendet e adhurimit po mbyllën dhe njerëzit nuk janë të lirë të adhurojnë apo të ushtrojnë besimin e tyre. Në xhamitë dhe vendet e vogla për lutje ku shteti lejon adhurimin, është vënë në fuqi një disiplinë e ashpër nga policia dhe ushtria. Për shembull, në Turkestanin Lindor (Xinjiang), Muslimanët nuk mund t'i kryejnë lutjet e tyre në xhamitë e tyre të preferuara apo të qëndrojnë në xhami për aq kohë sa dëshirojnë. Nëse punojnë në një zyrë të shtetit, nuk mund të agjërojnë apo t'i kryejnë lutjet e tyre. Ata Muslimanë të cilët shkojnë në xhami janë të vëzhguar nga afër nga agjentët sekret të policisë. Muslimanët nën moshën 18 vjeçare nuk mund të marrin edukatë fetare dhe nëse qeveria zbulon se kanë filluar ta studiojnë Kur’anin, pa marrë parasysh se çfarë moshe kanë, ata arrestohen dhe familjet e tyre dënohen. Por kjo politikë zyrtare e shtypjes dhe dhunës nuk i ndalon njerëzit që t'i kthehen fesë.

Përkundër zbatimit të rreptë të këtyre masave, siç njofton botimi i revistës Aziatike *Time*, feja në Kinë po rritet:

Megjithatë, përkundër përpjekjeve të Kinës për të kufizuar shprehjen fetare, zgjimi shpirtëror i qytetarëve të saj nuk ka të ngjarë të zhduket. Edhe pse Partia sunduese Komuniste mbetet zyrtarisht ateiste, rrëzimi i ideologjisë Maoiste krijoi një boshllëk që feja po e ndihmon të plotësohet. 79

Megjithatë sadoqë të kontestoj këto shifra regjimi komunist në Kinë, rreth 200 milion Muslimanë jetojnë atje. Përkundër të gjithave, numri i atyre të cilët e falin namazin është rritur. 80

# KAPITULLI 5

## RIVENDOSJA E MARRËDHËNIEVE (AFRIMI) NË MES TË MUSLIMANËVE, TË KRISHTERËVE DHE ÇIFUTËVE

Rritja e Islamit pasqyrohet gjithashtu në rritjen e fundit të dialogut ndërfaqetar. Këto dialogje fillojnë duke pohuar se tri religjionet monoteiste kanë një fillim të përbashkët dhe mund të bashkohen në një pikë të përbashkët. Dialogje të tilla kanë qenë mjaft të suksesshme dhe kanë shkaktuar një afrim të rëndësishëm, posaçërisht në mes të Krishterëve dhe Muslimanëve. Në Kur'an, Zoti na bën me dije se Muslimanët i ftojnë Ithtarët e Librit (të Krishterët dhe Çifutët) të bashkohen në një bazë të përbashkët:

**Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë tjetër pos All-llahut, të mos i shoqërojmë Atij asnjë shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi Muslimanë (besuam një Zot)!" (Kur'an, 3:64)**

Të tri religjionet monoteiste kanë besime të përbashkëta dhe të njëjtat vlera morale. Besimi në Ekzistencën dhe Njësinë e Zotit, në engjuj, në Profetë, në Ditën e Fundit, në Parajsën dhe Ferrin janë parimet e tyre themelore të besimit. Veç kësaj, vetflijimi, nënshtrimi, dashuria, toleranca, respekti, mëshira, ndershmëria, shmangja nga keqbërja dhe padrejtësia dhe të vepruarit në pajtim me ndërgjegjen janë të gjitha cilësi morale përgjithësisht të pranuar. Prandaj, pasi që këto tri religjione janë në të njëjtin nivel, ata duhet të punojnë së bashku për ta çrrënjësuar mosmarrëveshjen, konfliktin dhe dhimbjen e shkaktuar nga ideologjitë jofetare. Kur të merret parasysh nga ky këndvështrim, dialogu ndërfaqetar merr shumë më tepër rëndësi. Seminaret dhe konferencat që bashkojnë përfaqësuesit e këtyre feve dhe mesazhet e paqës dhe vëllazërisë që dalin prej tyre, kanë vazhduar rregullisht që nga mesi i viteve të 1990-ta.

Këto nisma janë shtuar që nga 9/11. Pas këtyre sulmeve, pjesëtarë të ndryshëm të klerit të Krishterë ishin në mesin e mbrojtësve më të rëndësishëm të Islamit, që thonin se nuk ekziston terror apo dhunë në Islam dhe se ai është fe e paqes, drejtësisë dhe tolerancës. Papa, udhëheqësi shpirtëror i Katolikëve të Romës dhe shumë pjesëtarë tjerë të shquar të klerit thanë se Islami dhe Muslimanët nuk mund të konsiderohen përgjegjës për këto sulme. Veç kësaj, të pakënaqur me këtë, ata kërkuan falje në emër të atyre të cilët i konsideruan Muslimanët përgjegjës dhe u përpoqën t'u shkaktojnë dëm Muslimanëve.

## Papa ftoi të Krishterët të agjërojnë

Një moment i rëndësishëm ndërftuar ndodhi kur Papa ftoi të Krishterët të agjërojnë me Muslimanët të Premtën (Xhumanë) e fundit të Ramazanit. Një një raport të lëshuar nga Vatikani thuhej:

Ati i Shenjtë, Papa Gjon Pali II, ka shpallur 14 Dhjetorin ditë agjërimi, faljeje dhe bamirësie në mbarë botën, duke u lutur për paqe, siç u shpreh ai në mesazhin e tij Engjëllor të 18 Nëntorit 2001: “Secili prej nesh që do të durojë duke agjëruar do të marrë përsipër natyrën e të varfërit, posaçërisht ata që tani vuajnë pasojat e terrorizmit dhe luftës.” 81

Kjo kërkesë hyri në fuqi menjëherë dhe të Premtën, më 14 Dhjetor, udhëheqësit e shquar të Krishterë vizituan xhamitë për faljen e Xhumasë dhe u falën me Muslimanët. Njëri prej këtyre ishte Kardinali Kryepeshkop i Detroitit. Në fjalimin e tij të së Premtes në njërën prej xhamive më të mëdha të Detroitit, Kardinali tha:

Ju falënderoj për ftesën e këndshme për të ndarë këto orë të shenjta të Ramazanit me ju dhe me xhematin (tubimin). Jam i lumtur në veçanti të jem me ju këtë të Premte, të 14 Dhjetorit, me ç’rast Kisha Katolike në mbarë botën solidarizohet me besimtarët Muslimanë gjithkund me lutje të posaçme, agjërim dhe dhënie lëmoshe për paqën botërore dhe për shërimin e gjithë atyre që vuajnë pasojat e luftës dhe terrorizmit. ... Ngjarjet e 11 Shtatorit na përkujtojnë se jo vetëm se teknologjia dhe ekonomia janë bërë globale, por pasiguritë, frikat, dhuna, padrejtësia dhe lufta janë bërë gjithashtu globale! Siç ka shpjeguar Papa, ajo që ne tani kemi nevojë është një përgjigje e asaj që ai e quan “bamirësi e globalizuar”. ... Në emër të të gjithë Katolikëve të metropolit të Detroitit, unë kërkoj falje dhe shpreh keqardhje për çfarëdo mënyre në të cilën pjesëtarët e Kishës sonë ju kanë ofenduar ndonjëherë me anë të vërejtjeve apo qëndrimeve paragjyquese, zëmërimin apo dhunës. 82

Në shërbimet fetare të Dielën pasuese, Muslimanët u lutën për të gjithë ata që ishin prekur nga terrori dhe lufta. Ndoshta për herë të parë në histori, shumë shërbime fetare të Krishtera filluan me një lexim nga Kur’ani. Në një kishë të Detroitit u lexua kjo lutje:

Le t’i lartësojmë mendjet dhe zemrat tona tek Zoti tani që lutemi për të gjithë ata të cilët kanë vdekur për shkak të terrorizmit; Zoti ju dhashtë shërim dhe paqë familjeve të tyre... Ne e lusim Zotin të ringjall në ne shpresën për një fillim të ri si një familje njerëzore. Dhashtë Zoti që ne së bashku të pranojmë dhe ndajmë faljen dhe mëshirën e Zotit. Ia nënshtrojmë veten tonë me plot përrulje dhe mirënjohje të Gjithëmëshirshmit dhe të Plotfuqishmit, Krijuesit të qiejve dhe tokës. 83

Pas kësaj, para leximit të Ungjillit, njerëzve të tubuar iu recitua Surja el-Fatiha. Ky padyshim se ishte një rast i jashtëzakonshëm dhe shenjë se një periudhë shumë e rëndësishme ka filluar. Ky afrim është një fazë e rëndësishme e përhapjes së parimeve morale fetare në mbarë botën.

# PËRFUNDIM

## LAJMET E GËZUARA TË SHEKULLIT 21

Në këtë libër kemi shtjelluar rënien e ateizmit gjatë 30 vjetëve të kaluara, rritjen e besimit në Zotin nëpër disa pjesë të botës dhe rritjen e religjionit. Ne poashtu treguam se faktori më i rëndësishëm në këtë rritje po luhet nga Islami. E morëm parasysh shkallën në rritje të konvertimit dhe interesimin e shprehur nga zyrtarët qeveritar, politikanët dhe mjetet e informimit për Islamin. Duke bashkuar gjithë këtë informacion, bëhet e qartë se ka një lëvizje të fuqishme drejt Islamit në shumë vende dhe se Islami është duke u bërë gjithnjë e më shumë tema më e rëndësishme e interesimit në botë. Këto zhvillime tregojnë se bota është duke lëvizur drejt një epoke krejtësisht të re, epokë në të cilën, me vullnetin e Zotit, Islami do të fitojë në rëndësi dhe mësimet morale të Kur'anit do të përhapen si një valë që rritet. Është e rëndësishme të kuptohet se ky zhvillim tejet i rëndësishëm u shpall në Kur'an 14 shekuj më parë:

**Ata përpiqen me gojët e tyre ta shuajnë dritën e All-llahut, e All-llahu nuk do tjetër, pos ta përsosë dritën e Tij ndonëse jobesimtarët e urrejnë. Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërgarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejë idhujtarët. (Kur'an, 9:32-33)**

Kur'ani gjithashtu tregon se parimet morale Islamike do të përhapen në mbarë botën, sepse Zoti ka paracaktuar si vijon:

**A tyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillë janë ata më të prishurit. (Kur'an, 24:55)**

Përhapja e parimeve morale të Islamit është njëri prej premtimeve të Zotit dhënë besimtarëve. Veç këtyre vargjeve, shumë thënie të Profetit tonë, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, pohojnë se mësimet morale të Kur'anit do të mbizotërojnë. Në ditët e fundit para fundit të botës, njerëzimi do të përjetojë një periudhë në të cilën keqbërja, padrejtësia, mashtrimi, hilja, luftërat, mosmarrëveshjet, konflikti dhe degjenerimi moral do të jenë të përhapura në mbarë botën. Pastaj do të vie Epoka e Artë, në të cilën këto mësimet morale do të fillojnë të përhapen midis njerëzve si një valë që rritet dhe përfundimisht të mbizotërojnë në mbarë botën. Disa prej këtyre thënieve, si edhe komentimet e mësuara mirë për to, janë dhënë më poshtë:

Gjatë kësaj (kohe), umeti (populli) im do të jetojë një jetë aq të rehatshme dhe të lumtur që ata kurrë më parë nuk e kishin jetuar. (Toka) do të jap frutet e saj dhe s' do të mbajë asgjë dhe pasuria në atë kohë do të jetë e bollshme. (Sunan Ibn-i Majah)

... Banorët e qiejve dhe të tokës do të jenë të kënaqur. Toka do të nxjerrë gjithçka që rritet dhe qiejt do të lëshojnë shi me bollëk. Prej gjithë të mirave që Zoti do t'u dhurojë banorëve të tokës, të

gjallët do të dëshirojnë që të vdekurit të rikthehen prap në jetë. (Yanabi' al-mawadda, Vëll. 2, faqe 177)

Toka do të bëhet si një tabaka e argjente e bimësisë që rritet... (Sunan Ibn-i Majah)

Toka do të jetë plot me barazi dhe drejtësi sikurse që ishte më parë plot shtypje e tirani. (Abu Davud)

... Nuk do të ketë padrejtësi apo tirani. (ad-Dani)

Bazuar në këto thënie, Epoka e Artë do të jetë një epokë në të cilën do të mbizotërojnë drejtësia, bollëku, begatia, mirëqenia, siguria, paqja dhe vëllazëria midis njerëzve, dhe epokë në të cilën njerëzit do të përjetojnë dashurinë, vetflijimin, tolerancën, dhembshurinë, mëshirën dhe besnikërinë. Në thëniet e tij, Profeti jonë, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, thot se kjo periudhë e bekuar do të përjetohet përmes ndërhyrjes së Mahdit i cili do të vie në fundin e kohës për ta shpëtuar botën nga kaosi, padrejtësia dhe shkatërrimi moral. Ai do t'i çrrënjos ideologjitë e pafe dhe do t'i jap fund padrejtësisë që mbisundon. Për më tepër, ai do ta bëj fenë ashtu siç ishte ajo në ditët e Profetit tonë, do të bëj që mësimet morale të Kur'anit të mbizotërojnë midis njerëzve dhe do të vendos paqë dhe mirëqenie në mbarë botën.

Kjo përgjegjësi e vështirë kërkon përpjekje të mëdha. Ka shumë mundësi që siç theksojnë disa dijetarë Islamik, që Mahdi, i cili do ta përmbush këtë qëllim, është një qenie shpirtërore e cila do të sundojë në ditët e fundit (Zoti e di më së miri). Kur të vie kjo kohë, kjo qenie shpirtërore do të përdor parimet morale të Islamit si bazë të saj për të udhëhequr njerëzimin në një botë të ndritshme në të cilën paqja dhe mirëqenia do të mbisundojnë. Kjo është ajo që nënkupton bërjen e punës së Mahdit.

Ngritja e Islamit që po përjetohet në botë sot, si edhe roli i Turqisë në epokën e re janë shenja të rëndësishme se epoka e paralajmëruar në Kur'an dhe në thëniet e Profetit tonë është shumë afër. Është dëshirë e përzemërt e jona që Zoti do t'na lejojë që të jemi dëshmitarë të kësaj kohe të bekuar.

# SHTOJCË

## MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Në ditën e sotme, ka njerëz të cilët jetojnë një jetë tejet të largët prej Zotit dhe të cilët madje refuzojnë besimin dhe mohojnë ekzistencën e Zotit për qëllime të tyre vetjake. Për shkak të verbërisë së tyre dhe të guximit të pamend të tyre, ata përpiqen të ndikojnë tek të tjerët dhe t'i largojnë ata nga udha e Zotit. Ata kanë parashtruar një varg të tërë idesh kundërthënëse dhe ideologji të shtrembëruara me anën e të cilave ta arrijnë këtë. Njëra prej këtyre është teoria e evolucionit.

### **Dështimi ideologjik i Darwinizmit**

Aspekti i Darwinizmit që e ndalon atë të jetë një pretendim interesi vetëm për botën shkencore dhe e bën atë me një rëndësi të madhe për shoqërinë si tërësi është dimension i tij ideologjik. Përgjigja që ai jap në pyetjen se si u krijuan gjallesat, duke përfshirë njerëzimin, e bën Darwinizmin bazën e një numri filozofish, botëkuptimesh dhe ideologjish politike.

Këtu, ne do të marrim parasysh raportin në mes të Darwinizmit dhe filozofisë materialiste. Filozofia materialiste, apo “materializmi,” është një sistem i të menduarit që shkon prapa në kohë deri në Greqinë e vjetër. Materializmi mbështetet në supozimin se materia është e vetmja gjë që ekziston. Sipas filozofisë materialiste, materia ka ekzistuar gjithmonë dhe do të vazhdojë të ekzistojë përgjithmonë. Pra sipas kësaj filozofie, asgjë nuk ekziston përtej materies.

Natyrisht, materializmi pasqyrohet gjithashtu në arenën politike, me komunizmin që zë vendin kryesor në këtë drejtim. Karl Marksi (1818-83) dhe Fridrih Engelsi (1820-95), të konsideruar si themelues të komunizmit, ishin poashtu themelues të materializmit dialektik. Sidoqoftë, komunizmi nuk është asgjë më tepër se filozofi materialiste e përshtatur për shkencat shoqërore nga Marksi dhe Engelsi.

Komunizmi sot konsiderohet si një ideologji e hedhur në plehrat e historisë, ndonëse e vërteta është se ai ende ka ndikim të jashtëzakonshëm. Efektet shkatërrimtare të kësaj ideologjie ende mund të ndihen në shumë vende.

Këtu Darwinizmi fiton rëndësi të madhe. Pasi që Darwinizmi apo teoria e evolucionit pohon se gjallesat nuk u krijuan por erdhën në jetë rastësisht, është pranuar gjerësisht prej ideologjive materialiste dhe është pranuar si “bazë themelore” e komunizmit në veçanti. Të gjithë ideologët kryesor komunist kanë pranuar teorinë fjalë për fjalë dhe kanë bazuar ideologjitë e tyre në të.

Për shembull, në një letër dërguar Fridrih Engelsit në vitin 1860, Karl Marksi thotë për librin e Darwinit se “Ky është libri i cili përmban bazën e historisë së natyrës për pikëpamjen tonë.”<sup>84</sup> Në një letër tjetër në vitin që pasoi, tani të dërguar Ferdinand Lasalit (1825-64), Marksi thotë: “Libri i Darwinit është shumë i rëndësishëm dhe më shërben si bazë e shkencës natyrore për luftën e klasave në histori.”<sup>85</sup> Ngjashëm Mao Ce Tunji, themeluesi i komunizmit Kinez, haptazi deklaroi se “Themelet e socializmit Kinez mbështeten në Darwinin dhe në teorinë e evolucionit.”<sup>86</sup>

Pra lufta intelektuale kundër komunizmit duhet t'i drejtohet filozofisë materialiste dhe, prandaj, teorisë së evolucionit. Është poashtu e qartë se pranimi i gjerë i teorisë së evolucionit në shoqëri do të ushqej edhe më tej materializmin si edhe komunizmin.

### **Dështimi shkencor i Darwinizmit**

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit *Origjina e Llojeve* të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.
  - 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë forcë evoluese.
  - 3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.
- Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

### **Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e Jetës**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pjetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

### **“Jeta buron nga jeta”**

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohej në mesjetë, lëndët e pjetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin *Origjina e Llojeve*, besimi se bakteriet formoheshin nga materia e pjetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrezuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gurthemelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: *“Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”* 87

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkencë, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

## **Përpyjekjet jobindëse në shekullin njëzet**

Evolucionisti i parë, i cili u muar me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave. 88

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazërat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbuloheshin se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës. 89

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale. 90

Të gjitha përpyjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “Earth (Toka)”, pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë? 91

## **Ndërtimi i ndërlikuar i jetës**

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht

është 1 në 10950 (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimeve). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimeve mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasiqë ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Poashtu duket e pamundshme ta kemi njërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike. 92

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u "krijua" në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

## **Mekanizmat imagjinarë të evolucionit**

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si "mekanizma të evolucionit", u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e "seleksionimit natyror." Rëndësia që i japte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: *Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror*...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhes që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale. 93

## **Ndikimi i Lamarkut**

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez

Shevalie Lamarck (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij *Origjina e Llojeve*, për shembull, ai thot se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shëndrruan në balena. 94

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencat e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

## **Neo-Darvinizmi dhe mutacionet**

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim. 95

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëjë asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

## **Të dhënat fosile: Asnjë gjurmë e formave kalimtare**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria e evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shëndrrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjëve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “**forma kalimtare**”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin *Origjina e Llojeve*, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.” 96

## **Shpresat e venitura të Darvinit**

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri. 97

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar poashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth zanafillës së qenieve të gjalla. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm. 98

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera **“origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucion, por krijimi.**

## **Përralla e evolucionit të njeriut**

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore. 99

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij *Një argument i gjatë* pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e *Homo sapiens*it, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.” 100

Kur konturojnë zinxhirin *Australopitek* > *Homo Habilis* > *Homo Erectus* > *Homo Sapiens*, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se *Australopiteku*, *Homo Habilis* dhe *Homo Erectus* kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës. 101

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si *Homo Erectus* ka jetuar deri në kohërat moderne. *Homo sapiens*, *Neandertalët* dhe *Homo Sapiens Sapiens* (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon. 102

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkeekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhënjë) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë. 103

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmëmajmun-gjysmënjeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e *Australopitekut*. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, rradhitet “perceptimi jashtëshqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtëshqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithëcka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë. 104

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zvarrosura prej njerëzve të caktuar, të ciët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

## Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër.

Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje

ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Deri më tani, asnjë aparat vizual apo regjistruar i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, përse i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

## **Kujt i takon ndërgjegja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafililit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

## **Një besim materialist**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shëndrruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj shkencëtar":

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore. 105

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me rradhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që "të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore."

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

## **Teoria e evolucionit është magjia më e fuqishme në botë**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton bestytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drunjë limoni dhe karanfila. Për më tepër, pasiqë shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për "magjinë më të fuqishme në histori." Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t'i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemëve në disa pjesë të Afrikës,

adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kur'an. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje japën në vazhdim:

**E ata që mohuan, për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde. Ata do të përjetojnë një dënim të dhimbshëm. (Kur'an, 2: 6-7)**

**...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Kur'an, 7: 179)**

**Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjujt e fshehtësitë), ata vetëm do të thonin: "Neve na janë ndalë sytë (të pamët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Kur'an, 15: 14-15)**

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërprehet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenare dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe paarsyeshmëri. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kur'ani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

**Ai (Musai) tha: "Hidhni ju!" E kur hodhën ata (shkopinjë e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe. (Kur'an, 7: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduk magjinë, apo "gëlltiti atë që ata kishin sajuar," siç përshkruhet në ajet.

**E Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopin tënd!" Kur ja, ai gëlltiste atë që kishin magjepsur. Atëherë u dëshmuua e vërteta dhe u zhduk ajo që kishin përgatitur. (Sure A'raf: 117-119)**

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjyquese, ata poashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

**Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmën.** Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jobindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon. 106

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngritet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

**Engjujt thanë: “Larg nga të metat je  
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër  
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,  
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”**

(Kur'an, 2: 32)